Do të zhvillohen mjete për rekrutimin, trajnimin dhe monitorimin e vullnetarëve. Theks i veçantë do të vendoset te vullnetarizmi i rinjve, trajnimi i vullnetarëve për situata emergjente, mbështetja e personave të moshuar, si dhe përfshirja e vullnetarëve në aktivitete programore dhe projektore.

3. Mbështetje gjithëpërfshirëse për refugjatët, migrantët dhe personat në lëvizje

Në kushtet e mundshme të lëvizjeve të reja migratore, do të forcohet përgjigjja emergjente përmes ekupeve mobile, logjistikës së përmirësuar për ndihmë humanitare, mbështetjes psiko-sociale, si dhe qasjes në programe integruuese për mësimin e gjuhës, punësim dhe orientim kulturor.

4. Forcimi i bashkëpunimit ndërsektorial dhe ndërkombëtar për ndikim më të madh.

Do të intensifikohet bashkëpunimi me vetëqeverisjen lokale, institucionet publike, sektorin qytetar dhe privat përmes projekteve të përbashkëta dhe rrjetëzimit. Do të sigurohet përfshirje më e madhe në iniciativa rajonale dhe ndërkombëtare, me fokus në

shkëmbimin e praktikave të mira dhe fonde të përbashkëta.

5. Rritja e transparencës dhe dukshmërisë përmes komunikimit

Do të zhvillohet procesi i komunikimit duke përdorur rrjetet sociale dhe mediat tradicionale, me qëllim informimin, edukimin dhe mobilizimin e publikut. Do të angazhohemi për transparencë në punë, duke vendosur theksin te nevojat e përdoruesve tanë.

6. Mobilizimi i fondeve

Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit mbetet i përkushtuar ndaj ndërtimit të marrëdhënieve partneriale dhe mobilizimit të sektorit korporativ, me qëllim përfundimtar – zgjerimin e mbulimit të përdoruesve dhe personave që kanë nevojë për ndihmë dhe mbështetje. Në këtë drejtim, është planifikuar vazhdimësia e mbështetjes nga Komercijalna Banka ShA Shkup, Marriott Hotel, OKTA, Silk Road Bank, EastGate Mall, UNDP, Ramstore Mall, Limak Luxury Hotel, furra Dime, Pekabesko ShA Shkup, Ragusa Group, Klinika "Zhan Mitrev", Loteria Shtetërore e Maqedonisë, NLB Tutunska Banka, moto-klubi

Hells Angels si dhe individë, institucione dhe figura publike.

7. Mirëmbajtja dhe zhvillimi i strukturës dhe menaxhimit

Pas përfundimit të procesit zgjedhor, do të vazhdojë puna e rregullt e përbërjes së re të Asamblesë, Bordit Drejtues dhe komisioneve brenda Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit. Do të azhurnohen rregullisht format për monitorimin e rezultateve dhe vlerësimin. Do të forcohet koordinimi me organizatat komunale përmes planifikimeve të përbashkëta dhe realizimit të aktiviteteve të koordinuara në terren.

INFORMIMI

Qëllimi i programit: Informim në kohë, i saktë dhe transparent mbi aktivitetet e organizatës, në të cilat përfshihen vullnetarët, profesionistët, donatorët dhe partnerët.

Përmes komunikimit të rregullt dhe strategjik me publikun do të përmirësohet transparenca, besueshmëria dhe imazhi pozitiv i organizatës në tërësi.

Informacion i shkurtër: Kanalet moderne digjitale dhe mediat sociale kanë ndryshuar dukshëm mënyrën e komunikimit me publikun. Shpejtësia e shpërndarjes së informacionit dhe interaktiviteti mundësojnë përfshirje më të madhe të qytetarëve dhe partnerëve në aktivitetet e Kryqit të Kuq.

Përmes kësaj qasjeje:

- informojmë qytetarët për aktivitetet, mundësitë për vullnetarizëm dhe mënyrat e marrjes së mbështetjes;
- informojmë donatorët dhe partnerët për aktivitetet e realizuara dhe rezultatet;
- rrisim dukshmërinë dhe njohshmërinë e organizatës si një subjekt humanitar relevant dhe i besueshëm;
- sigurojmë transparencë dhe rrjedhë të shpejtë informacioni për të gjitha palët e interesuara.

Rezultatet e pritura:

- Realizimi i 60 paraqitjeve televizive (pjesëmarrje në programe të mëngjesit, lajme, lidhje dhe emisione tematike);
- Kryerja e 50 intervistave radio/telefonike dhe pjesëmarrjeve në programe;
- Publikimi i mbi 200 përmbajtjeve në mediat sociale (Facebook, Instagram, X/Twitter, TikTok) për të rritur ndërveprimin dhe ndjekësit;
- Përditësimi i rregullt i faqes së internetit të organizatës me lajme, raporte dhe foto nga terreni;
- 50 publikime në e-buletin e KKR MV, me përmbledhje të aktiviteteve, histori të suksesshme dhe përvoja nga terreni;
- Organizimi i takimeve të rregullta me mediat (të paktën katër herë në vit) për përmirësimin e bashkëpunimit, koordinimit dhe mbështetjes në promovimin publik të aktiviteteve humanitare;
- Futja e formave të reja të komunikimit digjital, si përmbajtje të shkurtra video, intervista me vullnetarë, formate podcast dhe transmetime të drejtpërdrejta nga ngjarjet.

Në baza ditore, informacionet do të publikohen në kanalet e mëposhtme të komunikimit dhe informacionit:



www.ckgs.org.mk



Црвен крст на град Скопје
/City Red Cross of Skopje



cityredcrossofskopje



Skopje Red Cross



E-gazetën e KKR MV – buletin mujor me informacione dhe aktivitete nga i gjithë territori



Paraqitje në TV dhe radio, media të shtypura dhe onlajn.



DISSEMINIMI

Qëllimi i programit: Përmes organizimit të sesioneve dhe aktiviteteve të disseminimit, do të forcohet imazhi i organizatës, do të nxisë zhvillimi personal dhe profesional i vullnetarëve ekzistues dhe të rinj, dhe do të transmetohen njohuritë, vlerat dhe parimet e Kryqit të Kuq, me qëllim përfundimtar promovimin e një kulture aktive të vullnetarizmit dhe ndërtimin e besimit dhe njohshmërisë në komunitet.

Info e shkurtër: Gjatë vitit 2026, programi do të përqendrohet në:

- Njohjen e qytetarëve, institucioneve, kompanive dhe të rinjve me misionin, historinë dhe parimet e Kryqit të Kuq;
- Promovimin e vlerave humane dhe standardeve etike të organizatës;
- Forcimin e partneriteteve me aktorët lokalë, sektorin privat dhe institucionet arsimore;
- Nxitjen e formave të reja të vullnetarizmit përmes qas-

jeve moderne dhe mjeteve digjitale për komunikim dhe promovim.

Rezultatet e pritura:

- Mbajtja e 12 sesioneve të rregullta të disseminimit (një në muaj) me synim për të përfshirë të paktën 100 pjesëmarrës – vullnetarë të rinj, praktikantë, nxënës, profesionistë dhe anëtarë të komunitetit;
- Realizimi i kurseve dhe trajnimeve për vullnetarët dhe instruktorët ekzistues, me fokus në përmirësimin e aftësive të komunikimit dhe prezantimit;
- Disseminim i vazhdueshëm si pjesë përbërëse e programit CKA-PVH, përmes aktiviteteve për promovimin e vlerave humane tek të rinjtë;
- Organizimi i sesioneve të specializuara për pjesëmarrësit në garat e Ndhmës së Parë dhe ngjarje të tjera tematike.

PROGRAMI KKA-PVH

Qëllimi i programit: Të inkurajohet përfshirja aktive e të rinjve nga komunitete të ndryshme etnike, kulturore dhe sociale në aktivitete dhe projekte të përbashkëta që promovojnë humanizmin, tolerancën, kohezionin social dhe kulturën e dialogut. Përmes programit, mundësohet rritja e numrit të vullnetarëve të rinj në çdo Organizatë Komunale të Kryqit të Kuq (OKK), motivimi dhe mbajtja e tyre përmes veprimit praktik në komunitet dhe realizimit të projekteve të vogla humanitare.

Informacion i shkurtër: KKA–PVH është program nacional për edukimin dhe angazhimin e të rinjve nga 13 deri në 18 vjeç, si pjesë e forcimit strukturor të potencialit të vullnetarizmit të të rinjve në Kryqin e Kuq.

Programi bashkon të rinjtë përmes aktiviteteve që promovojnë vlera si respekti, solidariteti dhe ndihma reciproke, duke i edukuar ata për zhvillimin e projekteve të vogla lokale që kontribuojnë në përmirësimin e kushteve në komunitet.



Gjatë vitit 2026, do të punohet në:

- Përmirësimin e kapaciteteve të udhëheqësve të rinj dhe instruktorëve përmes trajnimeve praktike dhe mbështetjes mentorale;
- Nxitjen e projekteve të vogla inovative dhe të qëndrueshme me ndikim të fortë shoqëror;
- Zhvillimin e mjeteve digjitale dhe promovimin online për më shumë dukshmëri të rezultateve të programit;
- Promovimin intensiv të dialogut ndërkulturor dhe vlerave humane midis të rinjve.

Rezultatet e pritura:

- Trajnimi i 40 diseminatorëve të rinj PVH në çdo OKKK, me fokus në komunikim, punë në ekip dhe aftësi prezantuese;
- Realizimi i 120 trajnimeve në terren (3 në çdo OKK) për rreth 1,200 të rinj, mbi temat e diseminimit, zhvillimit dhe realizimit të projekteve të vogla, si dhe dokumentimin dhe promovimin e tyre;

- Realizimi i rreth 150 projekteve të vogla për përfitimin e komunitetit, duke mbështetur direkt mbi 3,500 persona në rrezik;
- Vlerësimi i çdo pjesëmarrësi me një certifikatë dhe njohje për angazhimin dhe kontributin e tyre vullnetar në komunitet;
- Organizimi i Javës PVH (21–27 shtator) në nivel nacional, me aksione të përbashkëta, ngjarje dhe fushata për promovimin e paqes, tolerancës dhe respektit reciprok;
- Formimi dhe fuqizimi i klubeve të të rinjve në të gjitha OKKK për një cikël të ri aktiviteteve në vitin 2027

Partnerë dhe bashkëpunëtorë:

Programi është kombëtar dhe realizohet me mbështetje financiare nga Shoqata Nacionale (Kryqi i Kuq i RMV) dhe me kontribut nga OKKK, sipas vendimit të Bordit Drejtues të KKRMV.

TË RINJTË

Qëllimi i programit: Qëllimi kryesor i departamentit është nxitja e vlerave humane dhe përgjegjësisë shoqërore tek të rinjtë, si dhe integrimi dhe angazhimi i tyre aktiv brenda organizatës.

Informacion i shkurtër: Aktivitetet e departamentit fokusohen në realizimin e prioriteteve të vendosura përmes formës së organizuar të veprimit rinor – Klubi i të Rinjve. Brenda departamentit realizohen aktivitete parandaluese shëndetësore dhe aktivitete sociale dhe humanitare, si dhe iniciativa programore dhe projektore në përputhje me nevojat dhe prioritetet aktuale të komunitetit.

Rezultatet e pritura:

- Në kuadër të aktiviteteve drejt mbështetjes dhe socializimit të personave me kufizime, si dhe fëmijë të vendosur në familje pritëse, është paraparë realizimi i 16 punëtorive kreative dhe edukative, si dhe përkujtimi i tre ditëve ndërkombëtare kushtuar personave me kufizime dhe Ditës Botërore të kujtarëve.
- Përmes aktiviteteve të planifikuara, do të realizohen aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin publik mbi shëndetin si prioritet kryesor i individit, si dhe nxitja e



qytetarëve dhe sektorit korporativ për të përmirësuar përgjegjësinë e tyre shoqërore.

- Gjatë vitit do të realizohen dy kampe verore për rritjen dhe zhvillimin personal të të rinjve, si dhe kampi tradicional veror për personat me anomali kongjenitale të zemrës (AKZ), në bashkëpunim me Klinikën “Zhan Mitrev”.
- Është planifikuar edhe rrjetëzim me organizata që punojnë me të rinjtë, për të krijuar mekanizma për mbështetje të ndërsjellë, shkëmbim përvojash dhe forcimin e kapaciteteve të vullnetarëve për zhvillim personal dhe profesional.
- Më tej, do të organizohen koncerte dhe manifestime publike për të përfshirë kompani, qendra tregtare dhe

figura publike në promovimin e aktiviteteve të Kryqit të Kuq. Në kuadër të përkujtimit të 8 Majit – Ditës Botërore e Kryqit të Kuq dhe Gjysëmshënës së Kuqe, do të mbahet manifestimi “Oskar i Humanizmit”, ku do të ndahen mirënjohje për kompani dhe individë që kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në realizimin e aktiviteteve programore të organizatës..

Partnerë dhe bashkëpunëtorë:

Në realizimin e aktiviteteve vazhdimisht përfshihen Komercijalna Banka AD Shkup, Kopshti Zoologjik Shkup dhe shumë organizata dhe individë të tjerë..

VEPRIMTARIA SOCIALE – HUMANITARE

Qëllimi i programit: Sigurimi i mbështetjes për të gjithë qytetarët e rrezikuar social në territorin e qytetit të Shkupit, të cilët kanë nevojë për ndihmë humanitare. Përmes këtij departamenti, qytetarët dhe kompanitë mund të realizojnë donacione të ndryshme.

Informacion i shkurtër: Veprimtaria sociale-humanitare në Kryqin e Kuq të qytetit të Shkupit zbatohet në bashkëpunim me Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq në territorin e qytetit. Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit ka rolin koordinues për zbatimin e akti-



viteteve në nivel komunal. Aktivitetet realizohen gjithashtu përmes programeve, projekteve dhe shërbimeve të ndryshme pranë Kryqit të Kuq të qytetit të Shkupit.

Rezultatet e pritura:

- 7,000 familje të rrezikuara do të marrin ndihmë humanitare (ushqim, mjete higjienike dhe veshmbathje) në vit; nga këto, 2,000 persona do të marrin ndihmë në mënyrë të vazhdueshme dhe 5,000 persona do të përfshihen në raste të fatkeqësive natyrore, duke reduktuar kështu rrezikshmërinë në komunitet.
- Koordinimi i procesit të implementimit të softuerit në Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq në territorin e qytetit të Shkupit.

- Inkurajimi i sektorit korporativ për vazhdimin e bashkëpunimit dhe përfshirja e kompanive të reja në procesin e donacioneve për grupet më të rrezikuara sociale.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë:

Programi pritët të mbështetet nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Tutunska Banka, Sava Sigurim, Alkaloid, NLB Banka, Aeroporti TAV, restorante lokale në territorin e qytetit të Shkupit, donacione individuale, Agjenci të OKB-së, Unioni i Grave të qytetit të Shkupit, Klubet e pensionistëve në territorin e qytetit të Shkupit

QENDRA PËR QENDRIM DITOR PËR PERSONA TË PASTREHË PRANË KRYQIT TË KUQ TË QYTETIT TË SHKUPIT – MOMIN POTOK

Qëllimi i programit: Reduktimi i dukurisë së personave pa strehë dhe lehtësimi i nevojave të tyre përmes ofrimit të shërbimeve të përmirësuara dhe cilësore, ndihmës dhe mbështetjes për zgjidhjen e problemeve ekzistuese, përmes shërbimit të nevojave elementare të kësaj grupmoshe, si dhe realizimi i punës profesionale për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit, etiketimit dhe stigmatizimit.

Informacion i shkurtër: Punkti për personat e pa strehë të Kryqit të Kuq i vendosur në Momin Potok u hap në vitin 2008 dhe është vendi i vetëm i këtij lloji në qytetin e Shkupit, i cili gjatë 17 viteve të fundit ka ofruar shërbime të nevojshme për një nga kategoritë më të cënueshme – personat pa strehë, me qëllim integrimin dhe resocializimin e tyre në rrjedhat shoqërore të shëndetshme. Çdo të mërkurë dhe të premte, rreth 160 persona pa strehë e vizitojnë këtë qendër dhe marrin shërbimet e ofruara.

Në fillim të vitit 2025, punkti u licencua me sukses dhe mori lejen për të operuar si qendër për qëndrim ditor për persona pa strehë, duke mundësuar ofrimin e shërbimeve të reja të licencuara për ata persona që me vendim kanë të drejtë t'i përdorin ato shërbime çdo ditë pune.

Rezultatet e pritura:

- 160 persona të pastrehë do të përdorin vazhdimisht shërbimet që u ofrohen në Qendër (ushqime, mirëmbajtje të higjienës personale, kujdes dhe mbrojtje mjekësore, medikamente, mbështetje në sigurimin e dokumenteve dhe akses në sistemin e kujdesit social dhe shëndetësor, mbështetje psikologjike, forcim të aftësive personale, edukim shëndetësor, akses në informacion mbi tema me bazë gjinore, ekskursione, aktivitete për të mbështetur fëmijët nga familjet e pastreha dhe familjet në rrezik, etj.).



- 32 persona të pastrehë, në një periudhë prej tre muajsh (dhjetor-mars), do të përdorin shërbimet e strehimit me qëllim parandalimin e hipotermisë dhe vdekshmërisë në këtë grup të synuar.
- Do të përgatitet një Plan Individual Zhvillimi dhe Punësimi për 20 persona të pastrehë, nga të cilët 15 do të përfshihen në tregun e punës.
- Përmirësimi i punës me përdoruesit - menaxhimi i rasteve, përmes të cilit do të mbulohen 155 persona të pastrehë që vijnë në Qendër.
- Ofrimi i shërbimeve sociale të licencuara për 30 persona të pastrehë, duke hapur mundësi dhe sfida të reja për riintegrim të suksesshëm në sistem.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Funksionimi i suksesshëm i qendrës mbështetet nga donacionet e partnerëve të gjatë, duke përfshirë Alkaloid ShA Shkup, Pekabesko,

Veze Sharri, Osogovski Milk dhe Rudine, si dhe kompaninë Zhito Leb dhe furra Dime nga të cilat presim përkrahje edhe në vitin 2026.

Me rëndësi të madhe është përkushtimi i restoranteve Ragusa, Toto, Dukat, LL Catering, Tetka Biberce dhe Skara Bar, të cilat e njohin seriozitetin e problemeve me të cilat përballen të pastrehët, dhe këto kompani donatore vazhdojnë bashkëpunimin dhe misionin e tyre humanitar.

Edhe në vitin 2026, mbështetja për personat e pastrehë vazhdon përmes projektit „Forcimi i shëndetit, aksesit, pjesëmarrjes dhe barazisë sociale në vendet e Ballkanit Perëndimor (SHAPE), i financuar nga Ministria Federale Austriake për Punë, Çështje Sociale, Shëndetësi, Kujdes dhe Mbrojtje të Konsumatorëve dhe Kryqi i Kuq Austriak.

PËRGATITJE DHE VEPRIM NDAJ FATKEQËSIVE



Qëllimi i programit: Veprim i vazhdueshëm i formës së specializuar operative të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit për ndërhyrje të shpejtë dhe efektive gjatë katastrofave në territorin e qytetit të Shkupit dhe në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Informacion i shkurtër: Programi për përgatitje dhe veprim gjatë fatkeqësive vazhdimisht trajnon vullnetarët për planifikim, organizim dhe ndërhyrje efektive gjatë katastrofave, si dhe informon qytetarët për mënyrat e përballimit të katastrofave dhe ndryshimeve klimatike. Aktivitetet përfshijnë organizimin e trajnimeve, ushtrimeve praktike dhe kurseve për licencimin e shpëtimtarëve në zona të ndryshme – sipërfaqe

ujore dhe terren malor – me qëllim rritjen e nivelit të përgatitjes dhe koordinimit gjatë ndërhyrjeve.

Rezultatet e pritura:

- Përmes organizimit të një kursi të ri për shpëtimtarë në ujë, me licencimin e 20 shpëtimtarëve të rinj dhe rinovimin e licencave për ata ekzistues.
- Zbatimi i trajnimit teorik dhe praktik për shpëtimtarë malorë (8 persona).
- Trajnimi i 10 vullnetarëve përmes kursit të avancuar nga ndihma e parë.

- Realizimi i një trajnimi për paraqitjen realiste të lëndimeve për nevojat e ushtrimeve simuluese.
- Organizimi dhe realizimi i 8–10 ushtrimeve simuluese për përgatitje gjatë katastrofave.
- Angazhimi i mbi 500 vullnetarëve për mbulimin e ngjarjeve sportive dhe kulturore dhe përfshirjen direkte/indirekte të mbi 10.000 personave.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Institucione të Sistemit për Menaxhimin e Krizave (QMK, DMSH MPB, ITM, BPPZ), Qyteti i Shkupit, Maratona e Shkupit, TREKS dhe kompani të tjera dhe institucione.

VEPRIMTARIA SHËNDETËSORE PARNDALUESE

Qëllimi i programit: Zbutja e faktorëve të rrezikut dhe nxitja e zakoneve të shëndetshme të jetesës përmes aktiviteteve preventive dhe mbrojtëse, me qëllim ruajtjen dhe përmirësimin e shëndetit të popullsisë.

Informacion i shkurtër: Programi është i fokusuar në zhvillimin e aktiviteteve për rritjen e vetëdijes së popullsisë për parandalimin dhe kontrollin e sëmundjeve më të shpeshta, në përputhje me kalendarin e aktiviteteve shëndetësore të Kryqit të Kuq. Aktivitetet përfshijnë:

- Shënimi i javëve tematike për luftën kundër sëmundjeve kardiovaskulare, kancerit, tuberkulozit, diabetit, HIV/SIDA dhe Java e Shëndetit Dental.
- Shënimi i Ditës Botërore të Ndihmës së Parë me përfshirjen aktive të Organizatave Komunale të Kryqit të Kuq (OOKK).
- Organizimi i Garës Komunale nga Ndihma e Parë për të rinjtë.
- Organizimi i vaksinimit kundër gripit sezonal.
- Pjesëmarrja në seminare dhe punëtori për të përmirësuar kapacitetet në fushën e veprimtarisë shëndetësore preventive.
- Sigurimi i kujdesit shëndetësor primar për personat me hyrje të paligjshme në RMV të vendosur në Qendrën e Pranimit për të Huaj dhe në Punktin për të Pastrehët.

Rezultatet e pritura:

- Shënimi i Ditës Botërore të Ndihmës së Parë me mbështetjen aktive të 50 punonjësve dhe vullnetarëve.
- Kryerja e 500 kontrolleve shëndetësore në Qendrën e Pranimit për të Huaj.
- Vaksinimi i 30 personave, përfshirë stafin dhe përdoruesit, kundër gripit sezonal.

- Realizimi i suksesshëm i Garës Komunale nga Ndihma e Parë me pjesëmarrjen e 90 të rinjve dhe 40 ekspertëve.
- Kryerja e 800 kontrolleve shëndetësore në Punktin për të Pastrehët.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Ministria e Shëndetësisë, institucionet private shëndetësore, mediat, OJQ-të.



QENDRA PËR TRAJNIM NGA NDIHMA E PARË

Qëllimi i programit: Sigurimi i një trajnimi cilësor dhe të standardizuar nga ndihma e parë, i destinuar për kandidatët për shoferë, punonjësit në subjekte juridike, qytetarët dhe personat që trajnohen për drejtimin e anijeve. Programi ka për qëllim përmirësimin e njohurive dhe aftësive praktike nga ndihma e parë, duke forcuar kështu sigurinë dhe gatishmërinë e qytetarëve për veprim në raste emergjente.

Informacion i shkurtër: Qendra për trajnimin nga ndihma e parë funksionon që nga viti 2020 si një njësi organizative brenda Kryqit të Kuq të Shkupit. Qendra ka pesë kabinete të specializuara, me kapacitet për deri 60 pjesëmarrës njëkohësisht. Për funksionimin e saj të përditshëm është përgjegjës një ekip prej tetë punonjësish (koordinator, doktor, staf administrativ dhe higjienist). Në realizimin e trajnimeve janë të përfshirë 60 doktorë – trajnerë të licencuar për dhënien e mësimin nga ndihma e parë dhe 12 demonstrues, të cilët kujdesen për aplikimin praktik të njohurive. Mësimi zhvillohet në gjuhët maqedonase, shqipe dhe angleze, sipas progra-

meve të akredituara dhe planeve mësimore të harmonizuara me standardet nacionale.

Rezultatet e pritura:

- Realizimi i 700 trajnimeve për shoferë, me pjesëmarrjen e rreth 8,000 personave.
- Organizimi i 70 trajnimeve për subjekte juridike, me 400 pjesëmarrës.
- Realizimi i 10 trajnimeve për individë, me gjithsej 50 pjesëmarrës.
- Realizimi i 30 trajnimeve të specializuara për drejtimin e anijeve, për 150 kandidatë.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Qendra bashkëpunon në mënyrë të vazhdueshme me: Ministrinë e Shëndetësisë, Ministrinë e Punëve të Brendshme, ambasadat, në kuadër të aktiviteteve projektore të Kryqit të Kuq të Shkupit dhe Kryqit të Kuq të RMV-së, si dhe me media publike – televizione, radio dhe të shkruara për promovim dhe informim të publikut.





Qëllimi i programit: Sigurimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të vazhdueshëm për dhurimin vullnetar të gjakut si bazë për furnizim të sigurt me gjak dhe përbërës të tij, përmes forcimit të përgjegjësisë shoqërore, rritjes së vetëdijes së qytetarëve dhe përfshirjes aktive të komunitetit, me qëllim të kontribuojë në stabilitetin dhe funksionimin e sistemit shëndetësor të vendit.

Informacion i shkurtër: Programi për dhurimin e gjakut promovon dhe mobilizon qytetarët përmes organizimit të aksioneve për dhurim gjaku, fushatave dhe ngjarjeve edukative, në koordinim me Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq, ITG, institucione dhe organizata partnere. Bazë e punës është në parimet e humanizmit, solidaritetit, pa pagesë dhe anonimitetit. Programi i kushton vëmendje të veçantë zhvillimit të zakoneve për dhurim të rregullt, përfshirjes së dhuruesve të rinj, veçanërisht të rinjve, dhe motivimit të dhuruesve të shumtë. Po ashtu, promovon Qendrën Ditore për dhurim gjaku si vend i njohur për humanizëm në qytet.

Rezultatet e pritura:

- Organizimi i 3 aksioneve të mëdha tradicionale të dhurimit të gjakut, për raste të rëndësishme:
 - ✓ 25 janar (në nder të Toshe Proeskit);
 - ✓ 26 korrik (Dita e Solidaritetit);
 - ✓ 13 nëntor (Dita e Çlirimit të Shkupit).

Këto aksione do të sigurojnë të paktën 350 njësi gjak.

- Realizimi i mbi 3,000 njësi gjak përmes dhurimeve të rregullta në Qendrën Ditore për dhënie gjaku.
- Avansim i koordinimit në terren përmes bashkëpunimit të forcuar me Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq dhe Institutit për medicinë transfuzive (IMT).
- Forcimi i kapaciteteve të anëtarëve të Klubit të Dhuruesve të Gjakut përmes pjesëmarrjes në trajnime, forume dhe punëtori për motivimin dhe mbështetjen e anëtarëve të rinj.
- Motivimi i dhuruesve përmes ndarjes së mirënjohjeve dhe çmimeve jubilar për individë dhe institucione që mbështesin dhurimin e gjakut.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë:

Instituti i medicinës Transfuzive, Kryqi i Kuq i RMV-së dhe Organizatat Komunale të Kryqit të Kuq, si dhe kompani private dhe shoqata që mbështesin misionin human të Kryqit të Kuq.

ASISTENCË PERSONALE PËR PERSONAT ME KUFIZIME

Qëllimi i programit: Të ndihmohen personat me aftësi të kufizuara për të arritur një nivel më të lartë të pavarësisë, për të shijuar të drejtat e tyre në tërësi dhe për t'u mundësuar liri zgjedhjeje dhe menaxhim të pavarur të jetës personale.

Informacion i shkurtër: Shërbimi social i asistencës personale, brenda Kryqit të Kuq të Shkupit, funksionon që nga viti 2018. Ky shërbim përfaqëson një proces sigurimi ndihme dhe mbështetje për personat me kufizime mbi 6 vjeç, nga asistentë personalë të certifikuar. Asistentët ofrojnë shërbime të përditshme në shtëpinë e përdoruesit, në komunitet dhe në vendin e punës ose procesin arsimor.

Rezultatet e pritura:

- Realizimi i trajnimit për asistent personal për personat me aftësi të kufizuara, ku do të trajnohen 20 asistentë personalë.
- Angazhimi i 110 asistentëve personalë që ofrojnë shërbime cilësore për 150 përdorues me kufizime të rënda dhe shumë më të rënda trupore dhe me humbje të plotë të shikimit.
- Realizimi i një punëtorie për forcimin e bashkëpunimit në grup (team building) me qëllim rritjen e motivimit të asistentëve personalë.
- Realizimi i një punëtorie për forcimin e bashkëpunimit mes Kryqit të Kuq dhe Qendrave për Punë Sociale (QPS) për përmirësimin e komunikimit dhe koordinimit brenda shërbimit.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Shërbimi financohet nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë. Organizata gjithashtu bashkëpunon me QPS dhe institucione të tjera dhe organizata të cilat targetojnë grupin e personave me aftësi të kufizuara.



NDIHMUES TË GRUPEVE TË RREZIKUARA TË PËRDORUESVE

Qëllimi i programit: Të sigurohet mbështetje dhe asistencë ditore për personat me aftësi të kufizuara dhe të moshuarit, me qëllim përfshirjen dhe integrimin e tyre në shoqëri dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Informacion i shkurtër: Angazhimi i personelit për ndihmë të të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara është një shërbim që funksionon që nga viti 2019 në territorin e qytetit të Shkupit. Ky shërbim është i vetmi në vendin tonë që ofron asistencë dhe kujdes për personat

me aftësi intelektuale, autizëm dhe disa gjendje të tjera si sindromi Daun, të cilat nuk mbulohen nga ligji për mbrojtjen sociale. Kjo do të thotë se këta 90 përdorues nuk mund të marrin këtë lloj shërbimi në asnjë shërbim apo program tjetër. Në vitin 2026, në bazë ditore, 90 përdorues do të marrin mbështetje nga 50 personel ndihmës dhe 11 vullnetarë.



Rezultatet e pritura:

- 90 përdorues do të marrin shërbimin ditë për ditë nga personeli ndihmës dhe vullnetarët.
- Trajnimi dhe angazhimi i 50 personel ndihmës.
- Trajnimi dhe angazhimi i 11 vullnetarëve.
- Realizimi i mbi 48,000 orëve për mbështetje dhe ndihmë të personave me aftësi të kufizuara dhe të moshuarve në baza ditore, duke përmirësuar kështu cilësinë e jetës së përdoruesve dhe familjeve të tyre.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi financohet nga Qyteti i Shkupit.

KOPÇE

Qëllimi i programit: Të mundësohet qasje më e lehtë tek veshjet për ata që kanë më shumë nevojë – familje në rrezik social, qytetarë me të ardhura të ulëta, por edhe për të gjithë ata që duan të blejnë në mënyrë të përgjegjshme dhe me çmime të përballueshme. Në të njëjtën kohë, programi krijon mundësi për punësim dhe angazhim të njerëzve nga kategori të cënueshme.

Informacion i shkurtër: “Kopçe” është një ndërmarrje sociale që mbledh donacione të veshjeve, i sorton dhe i shpërndan në tre mënyra:

- Falas, për ata që kanë më shumë nevojë;
- Përmes shitjes me çmime simbolike në një dyqan me veshje të dorës së dytë;
- Ose përmes donacioneve për organizata dhe institucione partnere.

Në këtë mënyrë, jo vetëm që sigurohet ndihmë konkrete, por edhe promovohet përdorimi i vetëdijshëm dhe i përgjegjshëm i resurseve, inkurajohet riciklimi dhe reduktohet sasia e mbeturinave të tekstilit. Kjo iniciativë inovative lidh mbështetjen

sociale, modën e qëndrueshme dhe kujdesin për mjedisin.

Rezultatet e pritura:

- Mbi 250 ton veshje të mblodhura dhe të përpunuara.
- 100 ton veshje të shpërndara tek individë dhe familje në nevojë.
- Mbi 3,700 persona kanë përdorur shërbimet e dyqanit “Kopçe”.
- Rritur ndërgjegjësimi ekologjik dhe social tek 1,500 qytetarë.
- Siguruar ndihmë direkte për mbi 250 familje në rrezik.
- Përfshirë 20 vullnetarë, të cilët kanë fituar përvojë praktike në fushën e mbështetjes sociale dhe menaxhimit të donacioneve.
- Realizuar mbi 300 orë punë vullnetare në sortim, organizim dhe shpërndarje të veshjeve.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi realizohet me mbështetje nga Qyteti i Shkupit, në bashkëpunim me organizata dhe individë të ndryshëm që kontribuojnë në misionin e tij.





BUTONI I EMERGJENCËS

Qëllimi i programit: Të përmirësojë cilësinë e jetës dhe të rrisë ndjenjën e sigurisë tek të moshuarit, duke u ofruar atyre mbështetje dhe ndërhyrje të shpejtë në situata emergjente ndërsa janë në shtëpitë e tyre.

Informacion i shkurtër: BUTONI I EMERGJENCËS është një shërbim inovativ që synon mbrojtjen dhe promovimin e jetës së pavarur të të moshuarve. Ai bazohet në një sistem komunikimi emergjent të thjeshtë, por jashtëzakonisht efektiv, i cili u lejon përdoruesve të kërkojnë ndihmë në rast emergjence - një rënie, përkeqësim të shëndetit, humbje të vetëdijes ose rrezik tjetër të paparashikuar - duke shtypur një buton.

Pajisja vendoset në shtëpinë e përdoruesit, është e lehtë për t'u përdorur dhe ofron lidhje 24/7 me një shërbim mbështetës. Kjo u jep të moshuarve një ndjenjë sigurie, ndërsa fami-

ljeve të tyre qetësi mendore dhe siguri se për të dashurit e tyre po kujdeset.

Ky shërbim ka potencialin të parandalojë pasojat serioze nga situatat e emergjencës, nëpërmjet ndërhyrjes në kohë dhe komunikimit të drejtpërdrejtë me një ekip profesional në terren.

Rezultatet e pritura:

- Mbi 130 përdorues të shërbyer çdo vit.
- Mbi 1500 thirrje të kryera.
- Mbi 30 pajisje të instaluar me përdorues të rinj.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi mbështetet nga Kryqi i Kuq Zvicëran, komuna e Kisella Vodës, komuna e Gazi Babës, komuna e Gjorçe Petrovit dhe komuna e Qendrës.

QENDRA DITORE PËR PERSONA TË MOSHUAR

Qëllimi i programit: Zhvillimi i formave të mbrojtjes jo-institucionale dhe ofrimi i kujdesit dhe mbështetjes shëndetësore për të moshuarit dhe personat e dobët.

Informacion i shkurtër: Nën moton „Ne të gjithë jemi fëmijët e tyre“, programi zbaton shërbimin social „Kujdesi Ditor për personat e moshuar për plakje aktive dhe Qendra e kujdesit në kushte shtëpiake“, i cili që nga viti 2011 vazhdimisht ofron mbështetje, kujdes dhe një cilësi më të mirë jetese për të moshuarit..

Rezultatet e pritura:

- Mbulim i 180 personave të moshuar në kushte shtëpiake dhe ata do të marrin shërbime shëndetësore dhe parandaluese çdo javë nga një ekip mjekësor.
- Mbi 5,000 vizita në shtëpi dhe më shumë se 600 orë vullnetare do të realizohen gjatë vitit. Vizitat do të kryhen në shtatë komunat e mëposhtme në territorin e qytetit të Shkupit: Qendër, Kisella Vodë, Çair, Butel, Karposh, Gjorçe Petrov dhe Saraj.



- Funksionim i vazhdueshëm i tre qendrave ditore për të moshuarit në:

- DHO „Dare Xhambaz“
- OKKK Çair
- Komuna Saraj

Mbi 500 aktivitete do të zbatohen në qendrat ditore për të inkurajuar plakjen aktive dhe të shëndetshme, dhe do të ofrohet mbështetje për personat në nevojë sociale përmes shpërndarjes së pakove ushqimore dhe produkteve higjienike, ilaçeve dhe suplementeve.

- Shënimin e Ditës Ndërkombëtare të personave të moshuar – 1 tetor dhe Javën e kujdesit për personat e moshuar, e cila mbahet të dielën e tretë të nëntorit.

Партнери и поддржувачи: Në vitin 2026, shërbimi social „Kujdesi ditor për persona të moshuar për plakjen aktive dhe qendra e kujdesit në kushte shtëpiake“ do të mbështetet nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë dhe Qyteti i Shkupit.

QENDRA E KUJDESIT



Qëllimi i programit: Përmirësimi i cilësisë së jetës së popullsisë së moshuar përmes sigurimit të mbështetjes së plotë, kujdesit dhe asistencës në kushtet e shtëpisë, si dhe përmes zh-

villimit të kapaciteteve profesionale në fushën e kujdesit social përmes trajnimeve të certifikuara për kujdestarë.

Informacion i shkurtër: Programi ofron kujdes të personalizuar për të moshuarit që për shkak të kufizimeve fizike ose shëndetësore nuk mund të kujdesen vetë, por nuk dëshirojnë të vendosen në institucione. Shërbimet ofrohen në shtëpinë e tyre për të ruajtur dinjitetin, rehati dhe ndjenjën e përkatësisë, përmes një qasjeje individuale dhe angazhimit të kujdestarëve profesionalë të trajnuar dhe të certifikuar.

Rezultatet e pritura:

- Mbi 150 të moshuar do të marrin mbështetje përmes shërbimeve të asistencës dhe kujdesit në kushte shpëtiake.

- Angazhimi i 50 kujdestarëve të trajnuar dhe profesionalistë, të cilët ofrojnë kujdes ditor dhe afatgjatë.
- Realizimi i dy trajnimeve të certifikuara, ku janë trajnuar mbi 30 kujdestarë të rinj, me qëllim forcimin e kapaciteteve të komunitetit lokal në fushën e kujdesit joformal.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi realizohet me mbështetjen e Kryqit të Kuq Zviceran, Ministrisë së Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Komunës Kisella Vodë dhe Komunës Karposh.

TRANSPORT I VEÇANTË PËR PERSONAT E MOSHUAR DHE PERSONAT ME KUFIZIME



Цел на програмата: Sigurimi i qasjes së pakufizuar në shërbime shëndetësore, sociale dhe administrative për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, përmes transportit të organizuar dhe të përshtatur që i përgjigjet nevojave të tyre fizike dhe shëndetësore.

Informacion i shkurtër: Të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara shpesh përballen me sfida serioze në lëvizjen në mjedisin urban. Mungesa e transportit publik të përshtatshëm, barrierat fizike dhe lëvizshmëria e reduktuar kufizojnë ndjeshëm aksesin e tyre në shërbimet bazë, si kontrolle mjekësore, mbrojtje sociale, procedura administrative dhe nevoja të tjera ditore.

Programi i transportit të veçantë ofron një zgjidhje praktike për këto sfida, duke siguruar qasje të organizuar, të sigurt dhe humane drejt institucioneve. Automjetet e përdorura janë të adaptuara me rampa, pajisur me sisteme sigurie të përshtatshme, ndërsa shoferët dhe personeli shoqërues janë të trajnuar për të punuar me persona me mobilitet të reduktuar dhe nevoja specifike.

Rezultatet e pritura: Realizimi i mbi 2,000 transportimeve me 4 automjete të dedikuara.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi mbështetet nga Kryqi i Kuq Zviceran, Komuna Kisella Vodë, Komuna Gazi Babë, Komuna Karposh, Komuna Gjorçe Petrov dhe Komuna Qendër.



QENDRA DITORE PËR PERSONA ME AFTËSI TË KUFIZUARA INTELEKTUALE MBI MOSHËN 18 VJEÇ "PROLET"

Qëllimi i programit: Socializimi dhe integrimi i personave me aftësi të kufizuara intelektuale, personave me aftësi të kufizuara të lehta dhe të moderuara dhe aftësi të kufizuara fizike mbi moshën 18 vjeç në shoqëri, si dhe kujdesi i përditshëm i tyre me mbështetjen e stafit në Qendrën Ditore.

Informacion i shkurtër: Qendra Ditore për personat me aftësi të kufizuara intelektuale mbi 18 vjeç punon me përdorues që nuk kanë vizituar asnjë Qendër Ditore për një kohë të gjatë ose janë të pakënaqur me kushtet e qendrave ekzistuese që i kanë vizituar tashmë. Është e hapur pesë ditë në javë me orar pune nga ora 08:00 deri në 16:00. Përmes punëtorëve dhe edukimit, terapive okupacionale dhe fizioterapisë, mundëson përmirësimin e gjendjes psiko-sociale, pavarësinë e tyre dhe një lloj lehtësimi për familjet e tyre ndërsa fëmijët e tyre përdorin shërbimet e Qendrës Ditore. Në përputhje me qëllimet, plani i veprimit është hartuar për t'u ofruar personave me aftësi të kufizuara intelektuale shërbime për programe trajnimi afatshkurtra dhe afatgjata, për të zhvilluar punëtori trajnimi dhe edukim për socializimin dhe integrimin e tyre në shoqëri, terapi okupacionale dhe punë individuale dhe kujdes për përdoruesit nga vetë stafi në Qendër.

Rezultatet e pritura:

- 10 deri në 15 përdorues do ta vizitojnë Qendrën në mënyrë aktive çdo ditë, do të marrin pjesë në aktivitete të përditshme përmes të cilave shoqërohen dhe socializohen. Përdoruesit, përmes aktiviteteve argëtuese, do të realizojnë punëtori artistike, krijuese dhe edukative, si dhe do të organizohen ekskursione dhe vizita në Parkun e Qytetit, Kopshtin Zoologjik, kinemanë, teatrin, muzetë.
- Përfshirje aktive e vullnetarëve nga klubet rinore të Qendrës së Kryqit të Kuq dhe Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit në realizimin e aktiviteteve të përditshme dhe punëtorëve krijuese me 10 deri në 15 përdorues të cilët do të edukojnë dhe socializohen.
- Ndërmjetësim për 8 përdorues të cilët do të marrin një biletë falas për transportin publik.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Qendra mbështetet nga Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, Qendra e Kryqit të Kuq Komunal, Makedonija Lek, LL Gurmet, Sigurimet Sava dhe Kompania e Pensioneve Sava.



PROGRAMI NACIONAL PËR NDIHMË DHE MBËSHTETJE PËR MIGRANTËT/REFUGJATËT NË RMV, INTEGRIMI I PERSONAVE NËN MBROJTJE NDËRKOMBËTARE DHE MBËSHTETJEN E PERSONAVE NGA UKRAINA ME QËNDRIM TË PËRKOHSHËM NË RMV PËR ARSYE HUMANITARE

Qëllimi i programit: Ofrimi i ndihmës dhe mbrojtjes humanitare për migrantët, pavarësisht nga statusi i tyre ligjor, origjina, feja, kombësia ose gjinia. Programi do të sigurojë akses gjithëpërfshirës dhe jodiskriminues në shërbimet humanitare, mbrojtje dhe mbështetje për të gjithë migrantët, në përputhje me standardet ndërkombëtare dhe parimet humanitare.

Informacion i shkurtër: Në kushte të lëvizjeve të vazhdueshme migratore në të gjithë territorin e Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe nevojës së vazhdueshme për ndihmë humanitare për njerëzit në lëvizje, Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2026 do të vazhdojë të ofrojë ndihmë humanitare, mbrojtje dhe mbështetje përmes aktiviteteve në kuadër të Programit Kombëtar për Ndihmë dhe Mbështetje për Refugjatët dhe Migrantët.

Aktivitetet synojnë të sigurojnë vazhdimësinë e ndihmës humanitare, të forcojnë mekanizmat e mbrojtjes dhe të përmirësojnë aksesin në shërbimet themelore për të gjitha kategoritë e njerëzve në lëvizje. Sipas vlerësimit të nevojave të migrantëve, programi do të kontribuojë në uljen e cenueshmërisë dhe mbrojtjen e dinjitetit të njerëzve në lëvizje, përmes një qasjeje të integruar që bashkon drejtimit e mëposhtme:

- Ndihmë humanitare për personat e kujdesur institucionalisht - migrantë në Qendrën e Shërbimeve Humanitare

Vinojug (Gjevgjeli) dhe Qendrën e Shërbimeve Tabanovce (Kumanovë);

- Ndihmë humanitare për personat në lëvizje brenda Pikës së Shërbimit Humanitar (QSHH) - Lojane, Komuna e Likovës;
- Forcimi i kapaciteteve kombëtare dhe lokale për reagim humanitar dhe përmirësimi i koordinimit brenda Sistemit Kombëtar të Menaxhimit të Krizave;

Rezultatet e pritura:

Në përputhje me angazhimet dhe qëllimet e programit të përcaktuara në misionin dhe mandatin e CCRSM-së, gjatë vitit 2026, Programi Kombëtar pritet të ofrojë ndihmë humanitare dhe mbështetje për 15,000 persona në lëvizje.

- Mbështetja humanitare do të përfshijë shpërndarjen e ushqimit, vakteve të ngrohta, ujit dhe artikujve jo-ushqimorë, si dhe ndihmën e shpejtë, transportin në institucionet e kujdesit shëndetësor sekondar përmes sistemit të referimit në kuadër të koordinimit me palët e tjera të interesuara në Sistemin Kombëtar të Menaxhimit të Krizave.
- Si pjesë e mbështetjes së vazhdueshme, programi do të vazhdojë me aktivitetet e Shërbimit për Kërkimin dhe Vendosjen e Lidhjeve Familjare dhe Ofrimin e Kujdesit Psiko-Social në bashkëpunim me Qendrën për Shëndet-

tin Mendor të QKRSHM-së.

- Në kontekstin e forcimit të karakterit lokal të programit, përmes Pikës së Shërbimit Humanitar - Lojane, aktivitetet synojnë:
 - Ndërtimi i besimit me popullsinë lokale dhe inkurajimi i solidaritetit;
 - Promovimi i aktiviteteve sipas Kalendarit Tradicional të CKRSM-së, në bashkëpunim me shkollat fillore dhe të mesme në komunën e Likovës;
 - Aktivitete për promovimin e shëndetit publik në kushte të një vale të përzier migrimi;

- Masa për uljen e rreziqeve nga fatkeqësitë, në bashkëpunim me popullsinë lokale në

Пртнери и соработници: Aktivitetet e programit do të zbatohen në koordinim me institucionet e sistemit, si dhe me mbështetjen e Kryqit të Kuq Zviceran, Organizatës Ndërkombëtare për Migrim (IOM) dhe OJQ-së Shërbimi Jezuit për Refugjatët në Republikën e Maqedonisë.

INTEGRIMI I PERSONAVE NË MBROJTJE NDËRKOMBËTARE

Qëllimi i programit: Ndihe dhe mbështetja e personave nën mbrojtje ndërkombëtare për t'u integruar me sukses në komunitetin e ri dhe për të ndërtuar një jetë të pavarur në ambientin e ri.

Informacion i shkurtër: Kryqi i Kuq i Shkupit, përmes aktiviteteve të tij të integrimit, ndihmon personat nën mbrojtje ndërkombëtare të realizojnë të drejtat nga sistemi i mbrojtjes sociale dhe shëndetësore, ofron mbështetje psiko-sociale, i referon për kurse të gjuhës maqedonase, zhvillon aktivitete të ndërmjetësimit kulturor dhe socializimit, siguron ndihmë humanitare dhe mbështetje, dhe nxit ose merr pjesë në aktivitete për avokim. Programi gjithashtu mbështet rritjen e punësimit dhe konkurrencës në tregun e punës, fuqizon kapacitetet e tyre, ndihmon dhe lehtëson procesin e gjetjes së strehimit dhe ofron mbështetje për kryerjen e procedurave administrative në institucionet përkatëse. Në vitin 2026, programi do të punojë për mbështetjen e 5 personave me status refugjati të njohur dhe 2 personave me status mbrojtjeje suplementare.

Rezultatet e pritura:

- Trajnimi i 30 vullnetarëve për menaxhimin e valëve migratore të përziera dhe integrimin përmes Shkollës Ndërkombëtare për Migracion.
- Trajnimi i 15 ndërmjetësuesve kulturorë.
- Realizimi i 5 takimeve për mbështetje psiko-sociale.
- Realizimi i 15 takimeve koordinuese me organizatat partnere, MTSP dhe CSR.
- Distribui i ndihmës humanitare çdo muaj.
- Organizimi i orëve të gjuhës maqedonase çdo javë.
- Realizimi i mbi 250 orëve mësimore për nevojat arsimore të fëmijëve me status refugjati në kushte shtëpie, të kryera nga 3 ndërmjetësues kulturorë.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi mbështetet nga Kryqi i Kuq i Shkupit, IFRC dhe Kryqi i Kuq Zviceran. Gjatë realizimit të aktiviteteve, Kryqi i Kuq bashkëpunon me MPsDM, CSR, MZMP dhe Shërbimi Jezuit për Refugjatë.





MBËSHTETJE PËR PERSONAT NGA UKRAINA NË RMV

Qëllimi i programit: Sigurimi i mbështetjes humanitare të përshtatshme dhe qasje në shërbimet bazë për personat nga Ukraina që qëndrojnë në RMV, me fokus në mbrojtjen dhe ndihmën për grupet e cënueshme, si dhe nxitjen e integritimit më efektiv në mjedisin lokal..

Informacion i shkurtër: Gjatë vitit 2026 do të vazhdojnë aktivitetet e dedikuara për mbështetjen e qytetarëve nga Ukraina që ndodhen në vendin tonë. Përmes këtyre ndërhyrjeve pritet të përfshihen rreth 150 persona. Aktivitetet synojnë përmirësimin e qasjes në shërbime, reduktimin e përjashtimit social, fuqizimin e kapaciteteve individuale dhe mbështetjen për qasje në tregun e punës. Pjesë e veçantë e programit është përkrahja për fëmijët, gratë, personat e moshuar dhe personat me sëmundje kronike.

Rezultatet e pritura:

- Rreth 150 persona (përfshirë një numër të konsiderueshëm fëmijësh dhe gra të rritura) do të marrin mbështetje psiko-sociale përmes seancave individuale

dhe grupe; qasje në informacione dhe shërbime shëndetësore, me ndërmjetësim dhe shoqërim; ndihmë materiale, përfshirë pako ushqimore dhe higjienike; dhe ndihmë financiare përmes sistemit të kuponëve, sipas kriterëve të përcaktuara më parë.

- Gjatë vitit do të realizohen aktivitete për adaptim më të lehtë në ambientin e ri, si orë mësimi të gjuhës maqedonase, rrjetëzim me sektorin korporativ dhe punëtori për fuqizimin e aftësive personale. Do të vazhdojë të funksionojë edhe qendra e lojërave (gaming center) si një zonë e sigurt për socializim dhe zhvillim të fëmijëve dhe të rinjve.

Partnerë dhe bashkëpunëtorë: Programi zbatohet në partneritet dhe bashkëpunim me Kryqin e Kuq Zviceran, UNHCR dhe aktorë dhe institucione të tjera lokale që mbështesin integrimin dhe mirëqenien e personave të zhvendosur nga Ukraina.

BUXHETI

KRYQIT TË KUQ TË QYTETIT TË SHKUPIT PËR VITIN 2026

HARXHIME	4,000,000.00	161,181,427.00	165,181,427.00	145,471,460.00	100.00
HARXHIME PËR RROGA DHE KOMPENSIME	2,100,000.00	6,000,000.00	8,100,000.00	7,490,000.00	4.90
HARXHIME MATERIALE	900,000.00	34,148,290.00	35,048,290.00	30,112,540.00	21.22
HARXHIME FUNKSIONALE	1,000,000.00	121,033,137.00	122,033,137.00	105,868,920.00	73.88
HARXHIME KAPITALE	0.00	0.00	0.00	2,000,000.00	0.00
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	161,181,427.00	165,181,427.00	145,471,460.00	0.00
DALLIMI	0.00	0.00			100.00

TË ARDHURA	Të ardhura nga Ligji për KKR	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
Mjete të përcjellura nga të ardhurat					
shtesë nga viti i kaluar	0.00	691,827.00	691,827.00	3,700,000.00	
Të ardhura nga qiratë	0.00	520,000.00	520,000.00	400,000.00	
Të ardhura nga buxheti lokal	0.00	113,457,600.00	113,457,600.00	16,900,000.00	
Të ardhura nga ndihma e parë	0.00	13,572,000.00	13,572,000.00	13,266,000.00	
Donacione dhe sponsorizime		4,870,000.00	4,870,000.00	2,560,000.00	
Të ardhura nga KKR MV	0.00		5,650,000.00	4,000,000.00	
Nga regjistrimi i veturave	4,000,000.00			0.00	
Od проекти	0.00			0.00	
Dhurimi i gjakut		150,000.00	150,000.00	150,000.00	
Fond për zhvillim dhe projekte të KKR MV		1,500,000.00	1,500,000.00	250,000.00	
Të ardhura nga kamata			0.00	0.00	
Të ardhura nga anëtarësia			0.00	0.00	
Të ardhura tjera		9,420,000.00	9,420,000.00	89,245,460.00	
Të ardhura nga shërbime tjera		17,000,000.00	17,000,000.00	15,000,000.00	
GJITHSEJ TË ARDHURA	4,000,000.00	161,181,427.00	165,181,427.00	145,471,460.00	

HARXHIME			Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
RROGA DHE KOMPENSIME	2,100,000.00	6,000,000.00	8,100,000.00	7,490,000.00	
Rroga bruto	2,100,000.00	6,000,000.00	8,100,000.00	7,490,000.00	
Kompensim për pushim vjetor			0.00	0.00	
Çmime jubilarë			0.00	0.00	
Kompensime për pension			0.00	0.00	
Pagesa tjera			0.00	0.00	

HARXHIME MATERIALE	900,000.00	34,148,290.00	35,048,290.00	30,112,540.00	
HARXHIME DITORE PËR UDHËTIM					
Mëditje në vend		90,000.00	90,000.00	0.00	
Mëditje për udhëtime jashtë vendit		120,000.00	120,000.00	0.00	

		Buget 2026	Buget 2025	%
RRYMË E HARXHUAR				
Energji elektrike		2,000,000.00	2,000,000.00	2,000,000.00
Harxhime për ujë		800,000.00	800,000.00	700,000.00
Mbeturina		225,000.00	225,000.00	200,000.00
Ngrohje		800,000.00	800,000.00	650,000.00
KOMUNIKIM DHE TRANSPORT				
Posta		50,000.00	50,000.00	120,000.00
Telefon		450,000.00	450,000.00	300,000.00
Internet		61,000.00	61,000.00	15,000.00
Karburant	400,000.00	900,000.00	1,300,000.00	1,500,000.00
Harxhime për regjistrim të veturave	200,000.00	280,000.00	480,000.00	300,000.00
Harxhime tjera për transport (pagesa rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)		80,000.00	80,000.00	60,000.00
MATERIALE				
Material zyreje		390,000.00	390,000.00	300,000.00
Abonim për revista		28,000.00	28,000.00	20,000.00
Pije dhe artikuj ushqimor		48,000.00	48,000.00	50,000.00
Pajisje për higjienë		239,000.00	239,000.00	200,000.00
Pagesa për reprezentacion		60,000.00	60,000.00	50,000.00
Materiale tjera	200,000.00	45,000.00	245,000.00	230,000.00
MIRËMBAJTJE RJEDHËSE				
Riparim dhe mirëmbajtje të veturave	100,000.00	200,000.00	300,000.00	350,000.00
Harxhime për mirëmbajtje të pajisjeve		131,000.00	131,000.00	180,000.00
Harxhime për mirëmbajtje të ndërtesës		376,000.00	376,000.00	440,000.00
Mirëmbajtje të softuerit dhe harduerit		250,000.00	250,000.00	29,000.00
SHËRBIME TJERA TË KONTRAKTUARA				
Shërbime avokati		72,000.00	72,000.00	72,000.00
Shërbime intelektuale (ligjërues, konsultantë)		718,000.00	718,000.00	690,000.00
Shërbime financiare (marrëveshje në vepër, shërbime konsultuese etj)		23,780,290.00	23,780,290.00	20,289,980.00
Provizion bankar		360,000.00	360,000.00	290,000.00
Sigurim i pronës dhe të të punësuarve		280,000.00	280,000.00	210,000.00
Shërbime tjera		1,115,000.00	1,115,000.00	866,560.00
HARXHIME FUNKCIONALE		1,000,000.00	121,033,137.00	122,033,137.00
VEPRIMTARI				
Organizim dhe zhvillim				0.00
Seanca e Bordit drejtues		50,000.00	50,000.00	50,000.00
Kuvendi i OKK//KKQSH		20,000.00	20,000.00	20,000.00
Informim dhe komunikim		30,000.00	30,000.00	24,000.00
Diseminim		10,000.00	10,000.00	10,000.00

		Бюджет 2026	Бюджет 2025	%
Veprimtaria shëndetësore edukative	180,000.00	180,000.00	150,000.00	
Ndihma e parë	10,800,000.00	10,800,000.00	9,700,000.00	
Dhurimi i gjakut	150,000.00	150,000.00	150,000.00	
Veprimtaria Sociale-humanitare	14,090,000.00	14,090,000.00	14,673,460.00	
Shërbimi kërkesë	82,393,137.00	82,393,137.00	67,891,460.00	
Marketing	300,000.00	300,000.00	400,000.00	
Financa	10,000.00	10,000.00	10,000.00	
Fatkeqësi (minimum 5% nga të ardhurat në baza të regjistrimit të veturave)	1,000,000.00	600,000.00	1,600,000.00	1,400,000.00
Bashkëpunim ndërkombëtar	11,500,000.00	11,500,000.00	10,190,000.00	
Të rinjtë	900,000.00	900,000.00	1,200,000.00	
MJETE TË PËRCJELLURA				
Transfere deri te organizatat bazë të KK		0.00		
Kotizim për KKR MV		0.00		
HARXHIME KAPITALE	0.00	0.00	0.00	2,000,000.00
BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRË				
Blerje të mobiljeve për zyrë		0.00		
Blerje të pajisjeve për IT dhe të tjera		0.00		
BLERJE TË AUTOMJETEVE				
Blerje të veturave		0.00		
MIRËMBAJTJE THEMELORE DHE SPECIALE				
Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore		0.00	0.00	2,000,000.00
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	161,181,427.00	165,181,427.00	145,471,460.00



KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ORGANIZATA KOMUNALE GAZI BABË

Programi vjetor i punës për vitin 2026 është përgatitur me qëllim që të zbatohen në mënyrë operative detyrat dhe aktivitetet e parashtruara për arritjen e qëllimeve të implementuara në Strategjinë 2030 në nivel të organizatës komunale, duke aplikuar formatin dhe strukturën logjike të Programit të punës. Programi është i orientuar drejt përmirësimit të shëndetit, mbrojtjes sociale të kategorive të cenueshme dhe gatishmërisë së popullatës për përgjigje dhe rezistencë në kushte fatkeqësish natyrore, përmes implementimit sistematik të programeve për Parandalim Shëndetësor, Ndhimja e parë, Dhurim i gjakut, Ndhimja sociale-humanitare dhe Përgjigje ndaj fatkeqësive.

Si prioritete në punën për vitin 2026, OKKK Gazi Baba vendos këto segmente:

1. Rritja e gatishmërisë lokale dhe kapacitetit për paralajmërim të hershëm, informim me qëllim ndërtimin e një komuniteti rezistent për përgjigje në kushte katastrofash dhe fatkeqësish natyrore.
2. Forcimi i mbështetjes sociale dhe solidaritetit.

3. Promovimi i vlerave humanitare, diseminimi i njohurive dhe angazhimi i vullnetarëve të rinj.

Veprimtaria shëndetësore parandaluese

Veprimtaritë shëndetësore parandaluese të OKKK Gazi Babë për vitin 2026 do të përqendrohen në parandalim të hershëm dhe zbulim të hershëm të sëmundjeve përmes edukimit dhe promovimit të zakoneve të shëndetshme të jetesës.

Aktivitetet do të jenë të orientuara drejt rritjes së ndërgjegjësimit për shëndetin publik, promovimit të zakoneve të shëndetshme dhe forcimit të bashkëpunimit me institucionet lokale shëndetësore dhe arsimore për edukim të hershëm dhe përfshirje në veprimtari parandaluese.

Shënimi i aktiviteteve kalendarike, si dhe edukimet për shënimin e Javës për luftën kundër sëmundjeve kardiovaskulare, Javës për luftën kundër kancerit, Javës për higjienë, Javës për luftën kundër TBC-së, Javës për luftën kundër diabetit, Muaji për luftën kundër sëmundjeve të varësisë, Javës për kujdesin dentar – me të cilat do të përfshihen mbi 500 pjesëmarrës – do të kontribuojnë në rritjen e ndërgjegjësimit publik.

Përmes realizimit të edukimeve mbi HIV/SIDA dhe infeksionet seksualisht të transmetueshme, parashikohet të përfshihen 300 deri 400 nxënës nga shkollat fillore dhe të mesme brenda Javës për luftën kundër HIV/SIDA-s.

Ndihma e parë

Ndihma e parë thekson rolin jetik të ofrimit në kohë dhe saktë të ndihmës së parë në shpëtimin e jetëve dhe zvogëlimin e pasojave nga lëndimet dhe gjendjet akute. Qëllimi është të rritet kapaciteti dhe gatishmëria e komunitetit përmes trajnimit të aktorëve kyç në komunitet, si shkollat, institucionet, sektori korporativ dhe vullnetarët.

Rritja e ndërgjegjësimit do të realizohet përmes trajnimeve nga ndihma e parë për 96 nxënës nga 16 shkolla fillore, trajnime nga ndihma e parë për 30 nxënës nga 5 shkolla të mesme, organizimit të një gare komunale nga ndihma e parë për promovimin e aftësive brenda komunitetit, punëtori nga ndihma e parë në 5 kopshte për 300 fëmijë të moshës 4 dhe 5 vjeç, Simulim i dhënies së ndihmës së parë në organizata pune, Realizimit të fushatës nën moton „Ndihma e parë shpëton jetë“, që do të përfshijë të gjitha institucionet arsimore në territorin e OKK Gazi Babë, si dhe shënimin e „Ditës Botërore të Ndihmës së Parë“.



Dhurimi i gjakut

Dhurimi i gjakut, si akt më i lartë i shprehjes së humanizmit, është një segment kyç për shpëtimin e jetëve dhe funksionimin normal të sistemit shëndetësor. Qëllimi i aktiviteteve të OK “Gazi Babë” për vitin 2026 është rritja e numrit dhe qëndrueshmërisë së dhuruesve të rregullt të gjakut, si dhe motivimi i dhuruesve të rinj.

Arritja e objektivit për sigurimin e mbi 2,735 njësi gjaku do të realizohet përmes një kalendari të qartë vjetor për dhurimin e gjakut, që përfshin 40 aksione të rregullta dhe të paktën 4 aksione të jashtëzakonshme, si dhe aktivitete në shkolla, universitete, institucione dhe sektorin korporativ përmes promovimit dhe organizimit të aksioneve për dhurim gjaku.

Në mënyrë të vazhdueshme do të punohet për rritjen e vetëdijes së publikut përmes fushatave të integruara, ngjarjeve lokale, promovimeve onlajn, materialeve informuese dhe prezencës në media, përfshirë shënimin e Ditës Botërore të dhurimit të gjakut.

Motivimi dhe ruajtja e dhuruesve do të stimulohet përmes ndarjes së çmimeve, plaketeve dhe mirënjohjeve për mbi 20 partnerë dhe mbështetës, falënderimeve të personalizuara dhe një sistemi për kujtesa të rregullta për dhurime të mëtejshme.





Do të forcohet gjithashtu bashkëpunimi me institucionet shëndetësore dhe partnerët lokalë për logjistikë, certifikim dhe dërgim të shpejtë të dhuruesve.

Dita e Komunës Gazi Babë do të shënohet me organizimin e një aksioni dhurimi gjaku, me pjesëmarrje të pritur prej mbi 50 dhuruesve.

Veprimtaria sociale-humanitare

Veprimtaria sociale-humanitare është e fokusuar në mbrojtjen dhe përmirësimin e standardit të jetesës dhe mirëqenies së individëve dhe komuniteteve. Në kuadër të programeve për vitin 2026, OK "Gazi Babë" vendos theksin të ndërhyrjet praktike dhe të matshme si mbështetje e drejtpërdrejtë për familjet dhe individët në rrezik, siguri dhe shpërndarja e ndihmës humanitare, aktivitete edukative për rritjen e vetëdijes dhe përgatitjen qytetare, si dhe organizimi i ngjarjeve të dedikuara solidaritetit dhe mbrojtjes së kategorive të rrezikuara, në bashkëpunim me institucionet lokale dhe sektorin korporativ.

Me realizimin e aktiviteteve të vazhdueshme dhe atyre të planifikuara kalendarike në vitin 2026 pritet të sigurohen mbi 500 pako ushqimore dhe 500 pako me produkte higjienike për kategori të cënueshme shoqërore, shpërndarja e mbi 7 ton rrobash të përdorura, këpucëve dhe shtrrojeve, 200 komplete të pajisjeve shkollore, 450 pakove për vitin

e ri, si dhe shënimin e Ditës së Solidaritetit, Javës kundër urisë, Ditës Ndërkombëtare kundër Trafikimit të Njerëzve, Ditës Ndërkombëtare të Personave të Moshuar, Javës së Kujdesit për të Moshuarit, etj

Vlerat humane dhe diseminimi (MHP)

Diseminimi, si një segment kyç në promovimin e punës së Kryqit të Kuq, është i pranishëm në realizimin e përditshëm të aktiviteteve. Promovimi i vlerave humane kontribuon në mobilizimin e vullnetarëve të rinj dhe forcimin e kapaciteteve ekzistuese. Diseminimi i punës së Kryqit të Kuq dhe vlerave humane brenda OKKK "Gazi Babë" në vitin 2026 do të realizohet përmes rganizimit të punëtorive diseminative në 17 shkolla fillore dhe 5 shkolla të mesme, 2 kopshte (10 degë), me çdo trajnim të planifikuar mbi tema të ndryshme – mbi 700 pjesëmarrës, 3 punëtorive diseminative për mbi 50 studentë, mobilizimit të 20 vullnetarëve të rinj në OK "Gazi Babë" dhe johjes së komunitetit me misionin dhe vizionin e Kryqit të Kuq dhe punën e OKKK "Gazi Baba". Do të shënohen edhe aktivitetet tradicionale përmes organizimit të ngjarjeve në hapësira publike, si: Dita Botërore e Kryqit të Kuq dhe Hënës së Kuqe, Java e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, Dita e Pavarësisë së Kryqit të Kuq të RMV-së, dhe Java e promovimit të vlerave humane.

Të rinjtë në Kryqin e Kuq

Të rinjtë përbëjnë një burim thelbësor në OKKK Gazi Babë, duke sjellë energji, kreativitet dhe perspektiva të reja që rrisin kapacitetin për mobilizim të shpejtë gjatë krizave dhe për realizimin e aktiviteteve edukative dhe parandaluese mes bashkëmoshatarëve. Pjesëmarrja dhe trajnimi i tyre forcojnë kapacitetet lokale, rrisin numrin e vullnetarëve dhe promovojnë solidaritet dhe përfshirje në komunitet. Klubi i të rinjve, si forma e organizimit të të rinjve në OKK "Gazi Babë", në vitin 2026 do të realizojë aktivitete të shumta, si: 2 trajnimeve që do të përfshijnë 15 anëtarë dhe vullnetarë si edukatorë mes bashkëmoshatarëve mbi tema të ndryshme, realizimi i aktiviteteve tradicionale dhe të projekteve të ndryshme, Përgatitja dhe realizimi i një kampi për të rinjtë për forcimin e kapaciteteve të vullnetarëve dhe anëtarëve të Klubit të të rinjve, pjesëmarrja në kampet nacionale të organizuara nga Kryqi i Kuq i RMV-së, pjesëmarrja në trajnime dhe seminare të organizuara nga Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit. Do të shënohen edhe aktivitete tradicionale si Java e Promovimit të Vlerave Humane, Java e të Rinjve në Kryqin e Kuq dhe Dita Botërore e Vullnetarizmit. Do të realizohen gjithashtu fushata onlajn për shprehjen e mirënjohjes për punën vullnetare, përmes shpalljes së "Vullnetarit të muajit" në rrjetet sociale,

si dhe urime për ditëlindje për vullnetarët dhe anëtarët e Klubit të të rinjve, të cilët krijojnë dhe realizojnë fushata për rritjen e ndërgjegjësimit mbi çështje të rëndësishme, si shëndeti parandalues, bashkëjetesa multikulturore, paqja dhe toleranca. Të rinjtë janë aktivisht të përfshirë në trupat udhëheqëse të organizatës (Bordi Drejtues, Këshilli i të Rinjve, trupat udhëheqëse të Klubit) dhe kontribuojnë në vendimmarrje për çështjet që i prekin ata. Në vitin 2026, parashikohet zhvillimi i bashkëpunimit me Kryqin e Kuq të Svilajnacit, Serbi, përmes shkëmbimit të vullnetarëve, me qëllim shkëmbimin e përvojave dhe forcimin e kapaciteteve.

Përgjigje ndaj fatkeqësive

Përgatitja dhe përgjigja ndaj fatkeqësive si aktivitet brenda OKKK "Gazi Babë" përbën një qasje të koordinuar për shpëtimin e jetëve në kohë, reduktimin e dëmeve dhe sigurimin e ndihmës së menjëhershme për komunitetet e prekura. Ky aktivitet përfshin masa parandaluese dhe përgatitore përmes trajnimeve në 10 shkolla, duke përfshirë mbi 200 nxënës; ushtrime simuluese në 5 shkolla me përfshirjen e mbi 1500 nxënësve dhe stafit arsimor; mobilizim të shpejtë të vullnetarëve dhe resurseve gjatë krizës; dhe bashkëpunim të organizuar me institucionet lokale, shërbimet shëndetësore dhe partnerët e tjerë. Qëllimi nuk është vetëm një përgjigje efektive dhe e shpejtë, por edhe forcimi i rezistencës së komuniteteve përmes masave parandaluese dhe fushatave edukative. Në lidhje me ndihmën për popullatën gjatë zjarreve, OKKK "Gazi Babë" ka parashikuar në vitin 2026 një buxhet për ndihmë për 20 deri 50 familje me ushqim, produkte higjienike, set kuzhine, batanije, çarçafë, veshje dhe këpucë të përdorura, dyshekë dhe të ngjashme. Gjatë valëve të nxehtësisë është planifikuar shpërndarja e të paktën 2000 shishe ujë gjatë periudhës së shpalljes së fazës portokalli në territorin e qytetit të Shkupit.

Forcimi i kapaciteteve të shërbimit profesional në fushën e përgatitjes dhe përgjigjes ndaj fatkeqësive do të arrihet përmes trajnimeve dhe seminareve të organizuara nga Kryqi i Kuq i RMV-së dhe Kryqi i Kuq i qytetit të Shkupit.

Informim dhe komunikim

Publikimi i rregullt i aktiviteteve dhe ngjarjeve të realizuara në rrjetet sociale (Facebook: <https://www.facebook.com/CKRMOOGaziBaba>, Instagram: Crvenkrstgazi-baba, You Tube kanali: Црвен крст на РСМ Општинска организација Гази Баба, komunikim përmes Viber) dhe E – gazeta e KKR MV. Informim dhe mobilizim i rregullt i dhuruesve të gjakut, vullnetarëve dhe anëtarësisë përmes platformës SMS Sender.

Partnerë

Mbështetje institucionale: Bashkitë lokale Gazi Babë, Ilinden, Petrovec dhe Haračinë.

Institucione arsimore: Bashkëpunim me 17 shkolla fillore, 5 shkolla të mesme, 7 institucione të arsimit të lartë, DUCOR "Partenie Zografski", konviktet studentore "Stiv Naumov" dhe "Tome Seniq", si dhe 2 institucione për fëmijë (2 kopshte dhe 10 degë).

Bashkëpunim me OJQ-të: SOS Fshati i Fëmijëve, Qendra e resurseve dhe Qendra këshilluese pranë SOS Fshatit të Fëmijëve, Qendra Krizë "Nadezh", "Jeta me Sfidë" – Marnastir, shoqatat lokale të pensionistëve dhe organizata të tjera.

Spektori korporativ: Vardar Gradba, JSP Shkup, Libraria Traki, Vitalia, Marketet "S", TAV, Grand Slot Club, DHL, Deni International, Pekabeko, Pharma Trade, Elmed, Macedonia Tourist, Joki, Hemiks, MAN, Niki Invest, MB Market, Implant, Nelt, Marketet Risal, Kadino Industry Group, Kompania Atanasovski, DB Schenker, Coca Farm, Bioil, Sieto, Restorant Potkovica, Grand Export.



BUXHETI

TË KRYQIT TË KUQ GAZI BABË PËR VITIN 2026

			Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
HARXHIME	4,000,000.00	4,240,000.00	8,240,000.00	7,520,000.00	0.00
HARXHIME PËR RROGA DHE KOMPENSIME	1,850,000.00	930,000.00	2,780,000.00	2,500,000.00	33.74
HARXHIME MATERIALE	591,000.00	643,000.00	1,234,000.00	913,000.00	14.98
HARXHIME FUNKSIONALE	1,721,000.00	1,305,000.00	3,026,000.00	3,407,000.00	36.72
HARXHIME KAPITALE	250,000.00	450,000.00	1,200,000.00	700,000.00	14.56
GJITHSEJ HARXHIME	4,412,000.00	3,328,000.00	8,240,000.00	7,520,000.00	0.00
DALLIMI	0.00	0.00			100.00

GJITHSEJ HARXHIME	<i>Të ardhura nga Ligji për KKRMV</i>	<i>Të ardhura tjera</i>	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
Mjete të përcjellura nga të ardhurat shtesë nga viti i kaluar		600,000.00	950,000.00	800,000.00	
Të ardhura nga qiratë			0.00	0.00	
Të ardhura nga buxheti lokal		750,000.00	800,000.00	700,000.00	
Të ardhura nga ndihma e parë		240,000.00	240,000.00	100,000.00	
Donacione dhe sponsorizime		650,000.00	300,000.00	220,000.00	
Të ardhura nga KKRMV	4,000,000.00	.	4,650,000.00		
Nga regjistrimi i veturave	4,000,000.00			4,600,000.00	
Nga projekte			0.00	0.00	
Dhurimi i gjakut		650,000.00	0.00	0.00	
Fond për zhvillim dhe projekte të KKRMV			0.00	0.00	
Të ardhura nga kamata			0.00	0.00	
Të ardhura nga anëtarësia		250,000.00	220,000.00	150,000.00	
Të ardhura tjera		580,000.00	550,000.00	500,000.00	
Të ardhura nga shërbime tjera		520,000.00	530,000.00	450,000.00	
GJITHSEJ TË ARDHURA	4,000,000.00	4,240,000.00	8,240,000.00	7,520,000.00	

HARXHIME			Бүгет 2026	Бүгет 2025	%
RROGA DHE KOMPENSIME	1,850,000.00	930,000.00	2,780,000.00	2,500,000.00	
Rroga bruto	1,850,000.00	830,000.00	2,680,000.00	2,270,000.00	
Kompensim për pushim vjetor		100,000.00	100,000.00	130,000.00	
Çmime jubilarë			0.00	0.00	
Kompensime për pension			0.00	0.00	
Pagesa tjera			0.00	100,000.00	
HARXHIME MATERIALE	591,000.00	643,000.00	1,234,000.00	913,000.00	
HARXHIME DITORE PËR UDHËTIM					
Mëditje në vend			0.00	0.00	
Mëditje për udhëtime jashtë vendit			0.00	0.00	
RRYMË E HARXHUAR					
Energji elektrike	110,000.00	110,000.00	220,000.00	180,000.00	
Harxhime për ujë	5,000.00		5,000.00	2,000.00	
Mbeturina			0.00	0.00	
Ngrohje			0.00	0.00	
KOMUNIKIM DHE TRANSPORT					
Posta	6,000.00		6,000.00	6,000.00	
Telefon	60,000.00	40,000.00	100,000.00	85,000.00	
Internet			0.00	0.00	
Karburant	85,000.00	25,000.00	110,000.00	140,000.00	
Harxhime për regjistrim të veturave	35,000.00	35,000.00	70,000.00	55,000.00	
Harxhime tjera për transport (pagesa rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)		12,000.00	12,000.00	10,000.00	

			Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
MATERIALE					
Material zyreje	30,000.00	15,000.00	45,000.00	45,000.00	
Abonim për revista			0.00	0.00	
Pije dhe artikuj ushqimor		35,000.00	35,000.00	15,000.00	
Pajisje për higjienë		6,000.00	6,000.00	6,000.00	
Pagesa për reprezentacion	50,000.00	45,000.00	95,000.00	35,000.00	
Materiale tjera	25,000.00	15,000.00	40,000.00	55,000.00	
MIRËMBAJTJE RJEDHËSE					
Riparim dhe mirëmbajtje të veturave	30,000.00	25,000.00	55,000.00	55,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të pajisjeve	20,000.00	15,000.00	35,000.00	27,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të ndërtesës			0.00	0.00	
Mirëmbajtje të softuerit dhe harduerit	20,000.00	10,000.00	30,000.00	22,000.00	
SHËRBIME TJERA TË KONTRAKTUARA					
Shërbime avokati			0.00	0.00	
Shërbime intelektuale (ligjërues, konsulentë)		140,000.00	140,000.00	30,000.00	
Shërbime financiare (marrëveshje në vepër, shërbime konsultuese etj)	35,000.00	35,000.00	70,000.00	10,000.00	
Provizion bankar	10,000.00	10,000.00	20,000.00	15,000.00	
Sigurim i pronës dhe të të punësuarve	40,000.00	35,000.00	75,000.00	65,000.00	
Shërbime tjera	30,000.00	35,000.00	65,000.00	55,000.00	
HARXHIME FUNKCIONALE	1,721,000.00	1,305,000.00	3,026,000.00	3,407,000.00	
VEPRIMTARI					
Organizim dhe zhvillim	40,000.00	30,000.00	70,000.00	100,000.00	
Seanca e Bordit drejtues			0.00	0.00	
Kuvendi i OKKK/KKQSH			0.00	0.00	
Informim dhe komunikim	35,000.00	15,000.00	50,000.00	30,000.00	
Diseminim		10,000.00	10,000.00	15,000.00	
Veprimtaria shëndetësore edukative	75,000.00	60,000.00	135,000.00	150,000.00	
Ndihma e parë	240,000.00	130,000.00	370,000.00	360,000.00	
Dhurimi i gjakut	240,000.00	180,000.00	420,000.00	390,000.00	
Veprimtaria Sociale-humanitare	350,000.00	220,000.00	570,000.00	550,000.00	
Shërbimi kërkesë	11,000.00		11,000.00	6,000.00	
Marketing	65,000.00	35,000.00	100,000.00	90,000.00	
Financa	45,000.00	35,000.00	80,000.00	120,000.00	
Fatkeqësi (minimum 5% nga të ardhurat në baza të regjistrimit të veturave)	150,000.00	150,000.00	300,000.00	600,000.00	
Bashkëpunim ndërkombëtar	80,000.00	40,000.00	120,000.00	246,000.00	
Të rinjtë	240,000.00	150,000.00	390,000.00	400,000.00	
MJETE TË PËRCJELLURA					
Transfere deri te organizatat bazë të KK		200,000.00	200,000.00	200,000.00	
Kotizim për KKR MV	150,000.00	50,000.00	200,000.00	150,000.00	
HARXHIME KAPITALE	750,000.00	450,000.00	1,200,000.00	700,000.00	
BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRË					
Blerje të mobiljeve për zyrë	350,000.00	150,000.00	500,000.00	200,000.00	
Blerje të pajisjeve për IT dhe të tjera	150,000.00	100,000.00	250,000.00	150,000.00	
BLERJE TË AUTOMJETEVE					
Blerje të veturave			0.00	0.00	
MIRËMBAJTJE THEMELORE DHE SPECIALE					
Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore	250,000.00	200,000.00	450,000.00	350,000.00	
GJITHSEJ HARXHIME	4,912,000.00	3,328,000.00	8,240,000.00	7,520,000.00	



KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ORGANIZATA KOMUNALE KARPOSH

Organizata Komunale Karposh edhe në vitin 2026 do të vazhdojë të jetë e përkushtuar ndaj realizimit të vizionit dhe misionit të saj, si dhe ndaj ruajtjes së vlerave dhe parimeve themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe. Programi për vitin 2026 është i fokusuar dhe i përshtatur sipas nevojave të sfidave të reja, me qëllim të sigurimit të veprimit humanitar të koordinuar dhe efektiv në territorin e komunave Karposh, Gjorçe Petrov dhe Saraj, ku jetojnë mbi 147,000 banorë nga përkatësi të ndryshme kombëtare dhe etnike.

Prioritete

Organizata Komunale Karposh në vitin 2026 do të intensifikojë aktivitetet për zhvillimin dhe fuqizimin e burimeve të saj njerëzore. Për këtë qëllim, do të promovohet dhe punohet me përkushtim për të motivuar vullnetarizmin e lirë. Përmes përdorimit të modelit të regjistrimit onlajn, sistemit të veprimit përmes klubeve shkollore dhe punëtorive orientuese, do të motivohen, tërhiqen dhe rekrutohen 50 deri në 100 anëtarë dhe vullnetarë të rinj. Për të rritur inkluzivitetin dhe diversitetin e kapaciteteve vullnetare, do të praktikohen bashkëpunime

ndërgjeneracionale dhe do të përgatiten dhe ofrohen angazhime të përshtatura për të moshuarit, personat me nevoja të veçanta dhe grupet e tjera të marginalizuara. Një theks i veçantë do të vihet mbi sigurinë dhe mbrojtjen e vullnetarëve, sidomos të atyre që punojnë në mjedise specifike. Angazhimi vullnetar do të monitorohet dhe regjistrohet rregullisht, ndërsa puna dhe përkushtimi do të vlerësohen dhe shpërblehen me falënderime, diploma, certifikata dhe njohje publike. Në vitin 2026 do të mbahen zgjedhjet e rregullta në Kryqin e Kuq për periudhën mandatore 2026–2030. Përmes njohjes së udhëheqësve të rinj me aktivitetet programore dhe ndarjes së qartë të përgjegjësisë midis drejtuesve dhe administratës, do të mundësohet integrimi i tyre i drejtpërdrejtë në proceset e vendimmarrjes dhe krijimit të politikave dhe udhëzimeve brenda organizatës. Reduktimi i rrezikshmërisë sociale dhe mbështetja për personat e rrezikuar do të jetë një prioritet që do të përfshijë aktivitete konkrete për sigurimin e një jete dinjitoze dhe mundësive të barabarta për të gjithë qytetarët, duke ulur marginalizimin dhe përjashtimin social. Do të zhvillohet dhe zgjerohet bashkëpunimi me kompanitë dhe institucionet me përgjegjësi shoqërore, të cilat janë kyçe për zhvillimin dhe qëndrueshmërinë e programeve

humanitare, dhe përmes aksioneve bamirëse dhe donatore do të nxiset solidariteti dhe humanizmi në komunitet. Një fokus i veçantë dhe prioritet në vitin 2026 do të jenë aktivitetet për zhvillimin e kapaciteteve për përgatitje, përgjigje efektive dhe rimëkëmbje nga fatkeqësitë, me qëllim kryesor sigurimin e mbështetjes për popullsinë e prekur. Do të sigurohen mallra materiale në ushqim, higjienë dhe pajisje shtëpiake si rezervë për reagim të shpejtë në rast të katastrofave, ndërsa 5–10 vullnetarë përmes pjesëmarrjes në trajnime dhe edukime të ndryshme, do të fitojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për ofrimin e ndihmës dhe shërbimeve për popullsinë e prekur nga fatkeqësitë. Për të siguruar një përgjigje cilësore dhe të shpejtë, Organizata Komunale do të bashkëpunojë me komunat, degët rajonale të Qendrës për Menaxhim të Krizave dhe Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, stacionet policore, shërbimin zjarrfikës dhe ndihmën e shpejtë mjekësore.

Diseminimi dhe KKA-PVH

Në fushën e diseminimit, gjatë vitit do të realizohen 5–10 punëtori, fushata lokale, kuize dhe lojëra për nxënës dhe të rinj mbi tema që lidhen me përdorimin dhe mbrojtjen e emblemës, vlerat humane, paqen, tolerancën dhe bashkëpunimin si parakusht për ndërtimin e një shoqërie multikulturore. Do të trajnohen 2 diseminatorë të rinj që do të realizojnë 20 punëtori diseminimi në komunitete të ndryshme, duke përfshirë 500 dëgjues: fëmijë nga kopshte, nxënës të shkollave fillore dhe të mesme, studentë, pensionistë, punonjës në sektorin publik dhe privat, si dhe anëtarë dhe vullnetarë të organizatës. Pjesëmarrja në implementimin e programit KKA-PVH do të realizohet përmes trajnimit të dy diseminatorëve të rinj në gjuhën maqedonase dhe shqipe, të cilët direkt përmes trajnimeve të përshtatshme do të aftësojnë dhe mbështesin 60 të rinj që do të hartojnë, implementojnë dhe dokumentojnë 4–6 projekte të vogla për të ndihmuar kategori të ndryshme të rrezikuara në komunitetin lokal.

Veprimtaria shëndetësore parandaluese

Për realizim më të suksesshëm dhe në kohë të aktiviteteve shëndetësore parandaluese, do të kryhet trajnim dhe edukim i 5–10 vullnetarëve të rinj. Ata, së bashku me edukatorët e bashkëmoshatarëve, do të përfshihen në aktivitetet për shënimin e të gjitha javëve të kalendarit tradicional të aktiviteteve të KKR në institucione arsimore, organizata pune dhe mes qytetarëve, duke realizuar 20–25 forma edukative mbi tema shëndetësore parandaluese, si dhe 3 akcione për kontrollë falas, matje të sheqerit në gjak dhe dhënie këshillash shëndetësore, të destinuara për 400–500 persona nga grupet më vulnerable të popullsisë. Në aktivitetet për përballimin e temperaturave të larta, ekipet mobile të Organizatës Komunale Karposh do të shpërndajnë ujë dhe flaerë me udhëzime dhe rekomandime për mbrojtje nga temperaturat e larta në vendet me frekuencë të lartë të qytetarëve.

Ndihma e parë

Do të vazhdojnë aktivitetet për edukim të gjerë dhe trajnim të popullsisë për dhënien e ndihmës së parë, me qëllim parandalimin dhe reduktimin në kohë të rreziqeve në aksidentet e përditshme. Për këtë qëllim, nga 5 mjekë të trajnuar dhe 6 demonstrues do të realizohen 25 seanca edukative me trajnime praktike të ndihmës së parë, duke përfshirë rreth 300 persona nga grupe të ndryshme të synuara: stafi arsimor, nxënës nga institucionet arsimore, të punësuar dhe të tjerë. Në organizimin e garës komunale nga ndihma e parë, në kategorinë e rinisë dhe fëmijëve do të përfshihen nxënës nga 25 shkolla fillore dhe 8 shkolla të mesme nga komunat Karposh, Gjorçe Petrov dhe Saraj, ndërsa më të mirët do të garojnë në garat e qytetit, rajonale dhe ato shtetërore nga ndihma e parë. Kurset nga ndihma e parë për trajnimin e kandidatëve për shoferë të automjeteve do të jenë në vazhdimësi me cilësi të lartë përmes Qendrës për Ndihmë të Parë në nivelin e qytetit të Shkupit. Në shënimin e Ditës Botërore të Ndihmës së Parë do të zhvillohen aktivitete për promovimin e ndihmës së parë përmes vendosjes së pikave informative, shpërndarjes së materialeve promovuese, organizimit të trajnimeve, demonstrimeve të teknikave dhe ushtrimeve interaktive për dhënien e ndihmës së parë para publikut, si dhe aktivitete edukative, krijuese dhe onlajn, kuize dhe promovim mediatik.





Dhurimi i gjakut

Promovimi dhe përmirësimi i dhurimit të gjakut, duke u bazuar në parimet e vullnetarizmit, anonimitetit dhe pa pagesë, si dhe siguri në kohë të gjakut, do të jetë një aktivitet i dalluar gjatë vitit 2026. Rritja e motivimit për dhënimin e gjakut, veçanërisht tek popullsia e re, do të sigurohet përmes mbajtjes së 15-20 punëtorive motivuese dhe edukative, të destinuara për 300-400 nxënës dhe studentë nga institucionet arsimore. Në bashkëpunim me Institutin për Mjekësi Transfuzioni, në shkollat e mesme, fakultetet, organizatat, kompanitë dhe mes qytetarëve, do të realizohen 40 aksione dhurimi gjaku, ku do të sigurohen rreth 3,800 njësi gjaku. Katër nga këto aksione, me karakter tradicional, do të mbahen në Organizatat Komunale të Karposhit për shënimin e 17 Marsit – „Dita e dhurimit të gjakut në RMV“, në komunat Gjorçe Petrov dhe Karposh për shënimin e Ditës së Komunave, dhe në Manastirin Matka për shënimin e festës fetare „Ngjitesa e Virgjreshës Mari“. Për rastet e 17 Marsit – „Dita e dhurimit të gjakut në RMV“ dhe 14 Qershorit – „Dita Botërore e Dhurimit të Gjakut“, do të organizohen aktivitete ku kryetarët e komunave do t'u japin mirënjohje dhuruesve të gjakut me dhurime jubilarë, si dhe individëve dhe organizatave që kontribuojnë në promovimin dhe përparimin e dhurimit të gjakut.



Veprimtaria sociale-humanitare

Me qëllim të sigurimit të mbështetjes dhe ndihmës së shpejtë, të koordinuar dhe efektive për personat e cenusshëm, do të zhvillohen dhe zgjerohen bashkëpunimet me kompanitë dhe institucionet shoqërisht përgjegjëse, të cilat janë kyçe për qëndrueshmërinë dhe zhvillimin e programeve humanitare. Në kuadër të shënimit të fushatave tradicionale të Kryqit të Kuq të RMV-së („Java e Solidaritetit“ dhe „Dita Kundër Urisë“), veçanërisht të rëndësishme do të jenë aktivitetet që sigurojnë një qasje participative dhe partneriale me kompanitë dhe institucionet shoqërisht përgjegjëse. Me kontributin e tyre dhe përfshirjen e 20-25 vullnetarëve të rinj, do të organizohen dhe realizohen dy aksione grumbulluese dhe forma të tjera për sigurimin e materialeve, të cilat do t'u dedikohen ndërhyrjes për 150-200 familje sociale në komunitet, si dhe për personat e moshuar dhe personat me nevojë të veçanta. Për shënimin e Ditës Botërore dhe Javës kundër trafikimit të njerëzve, tre edukatorë të rinj nga Organizata Komunale Karposh dhe ekspertë nga Departamenti për Parandalim në Ministrinë e Brendshme do të realizojnë 6 ligjërrata parandalimi për 120 nxënës nga shkollat fillore dhe të mesme. Për rastin e Ditës Ndërkombëtare dhe Javës së Kujdesit për Personat e Moshuar, në bashkëpunim me Shoqatat e pensionistëve në nivel lokal do të realizohen dy ligjërrata dhe punëtori edukative-kreative, si dhe dy vizita në Shtëpinë e Personave të Moshuar „Nënë Tereza“, duke përfshirë 80 persona të moshuar. Për shënimin e Ditës së të pastrehëve, në bashkëpunim me OJQ-në „Mirenjohja“, do të organizohen dy aksione për përgatitjen e vakteve të gatshme për personat e pastrehë në Shkup. Gjatë gjithë vitit, qytetarët do të kontribuojnë mbi 3 ton rroba të përdorura, batanije dhe këpucë në dy kontejnerë për donacione, të cilat do të shfrytëzohen për ndërhyrje sociale për 120-150 persona nga grupet e cenusshme në komunitet.

Të rinjtë

Të rinjtë vullnetarë të Kryqit të Kuq do të mbeten grupi më i madh dhe më aktiv i vullnetarëve, si dhe bartës të shumicës së aktiviteteve brenda organizatës. Për forcimin e aftësive organizative dhe lidhshimit tek të rinjtë, 10 vullnetarë të rinj do të marrin pjesë në punëtori, trajnime, kampe dhe seminare, ku do të fitojnë njohuri dhe aftësi të nevojshme për realizimin e suksesshëm të aktiviteteve. Përmes përdorimit të modelit të

anëtarësimi online, përmirësimi të punës së klubeve shkollore të Kryqit të Kuq, pjesëmarrjes në programin KKA-PVH, organizimit të ditëve të hapura për promovimin e aktivitetit rinor dhe realizimit të punësorive orientuese me vullnetarë potencialë, do të motivohet dhe tërhiqen 30-50 vullnetarë të rinj në organizatë. Nga vullnetarët e trajnuar do të realizohen 30 edukime ndërbashkëmoshatore për parandalimin e HIV/SIDA-s, trafikimit të njerëzve, sëmundjeve të shkaktuara nga varësitet dhe tema të tjera aktuale, ku do të përfshihen rreth 600 nxënës nga shkollat fillore dhe të mesme. Të rinjtë, si motor i ndryshimeve ekologjike, do të përfshihen aktivisht në programin “Vullnetarizëm i Gjellbër”. Përmes organizimit të 10 edukimeve ndërbashkëmoshatore, punësorive, lojërave dhe garave ekologjike, të rinjtë do të promovojnë zakone të shëndetshme dhe do të rrisin vetëdijen ekologjike dhe përgjegjësinë ndaj mjedisit të 200 nxënës dhe vullnetarë të organizatës. Do të vazhdojnë dhe përmirësohen aktivitetet për realizimin e projektit “HumanKo”, i cili synon ndihmën dhe mbështetjen në procesin edukativ dhe socializimin e 40 personave me nevoja të veçanta, ku do të përfshihen 15 vullnetarë nga Klubi i të Rinjve. Për herë të shtatë do të realizohet Kampi veror i titulluar “Të gjithë jemi të njëjtë”, për të cilin do të sigurohet mbështetje e plotë materiale dhe shërbime nga mbi 30 kompani shoqërisht përgjegjëse. Organizata komunale do të vazhdojë të ofrojë mbështetje të plotë dhe asistencë për iniciativat dhe aktivitetet rinore, veçanërisht në përgatitjen dhe realizimin e projekteve të pavarura të të rinjve.

Informimi, transparenca dhe llogaridhënia

Edhe në vitin 2026, do të vendoset theks i veçantë mbi informimin e shpejtë, të qartë dhe të aksesueshëm të publikut, vullnetarëve, anëtarëve, donatorëve dhe palëve të tjera të interesuara në komunitet. Për këtë qëllim, do të publikohen informacione dhe kumtesa për publikun, si dhe do të shpallen mbi 80 informacione nga aktivitetet në e-buletinën e KKR MV, në faqen e internetit dhe profilet e Organizatës Komunale Karposh në rrjetet

sociale (Facebook dhe Instagram), si dhe në mediat elektronike dhe të shtypura. Njëkohësisht, do të realizohen edhe pjesëmarrje në media dhe mbulime mediatike të ngjarjeve, dhe do të përmirësohet informimi dhe komunikimi me komunitetet lokale, institucionet, donatorët dhe mediat. Qëllimet dhe rezultatet e arritura do të prezantohen përmes përgatitjes së publikimeve mujore, tremujore dhe në tre gjuhë, si dhe përmes Raportit Vjetor dhe Financiar mbi punën e organizatës.

Partneritet dhe bashkëpunim

Përmes zhvillimit aktiv të partneriteteve cilësore, bashkëpunimeve dhe veprimeve të përbashkëta me institucionet publike, organizatat joqeveritare, sektorin privat dhe grupet qytetare, Organizata Komunale Karposh do të rrisë efikasitetin dhe përfshirjen e aktivitetëve humanitarë dhe do të forcojë rolin e saj si një aktor humanitar i besueshëm dhe përgjegjës në komunitet.

Në vitin 2026, do të zgjerohet dhe përmirësohet bashkëpunimi me komunat lokale Karposh, Gjorçe Petrov, Saraj dhe me Qytetin e Shkupit, me organizata qeveritare dhe joqeveritare, si dhe me kompani private, përfshirë: Degët rajonale të Qendrës për Menaxhim të Krizave dhe Drejtorinë për Mbrojtje dhe Shpëtim, stacionet policore, njësitë kundër zjarrit, Shërbimin e Urgjencës Mjekësore, Qendrën për Kujdes Social, Spitalin Special për Mjekësi Geriatrike dhe Paliative “13 Nëntori”, Shtëpinë e të Moshuarve “Nëna Terezë”, Spitalin Psikiatrik Shkup, Spitalin “Axiabadem Sistina”, Klinikën “Zhan Mitrev”, Qendra Shëndetësore Private “Azura”, institucionet arsimore dhe konviktin studentor “Goce Dellçev”, si dhe kompanitë Ading, Alkaloid-Lafoma, UHRM, ELEM-Shkup, Zhito Lluks, Ofis Plus, Vitalia, Samanta, Uka-Komerc, Gala Farm, Kam Market, Market Vero, QT City Mall dhe të tjera. Do të bashkëpunojmë dhe implementojmë programe dhe aktivitete edhe me organizata nga sektori joqeveritar, përfshirë shoqatat e pensionistëve, bashkësitë studentore dhe organizata të tjera qytetare.



BUXHETI

TË KRYQIT TË KUQ KARPOSH PËR VITIN 2026

	Të ardhura nga Ligji për KKR	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
HARXHIME	4.000.000.00	3.700.000.00	7.700.000.00	7.500.000.00	0.00
HARXHIME PËR RROGA DHE KOMPENSIME	1,600,000.00	1,200,000.00	2,800,000.00	2,630,000.00	36.36
HARXHIME MATERIALE	305,000.00	325,000.00	630,000.00	650,000.00	8.18
HARXHIME FUNKSIONALE	1,615,000.00	2,175,000.00	3,790,000.00	3,770,000.00	49.23
HARXHIME KAPITALE	480,000.00	0.00	480,000.00	450,000.00	6.23
GJITHSEJ HARXHIME	4.000.000.00	3.700.000.00	7.700.000.00	7.500.000.00	100.00
DALLIMI	0.00	0.00			100.00

TË ARDHURA	Të ardhura nga Ligji për KKR	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
Mjete të përcjellura nga të ardhurat shtesë nga viti i kaluar	0,00	2,400,000.00	2,400,000.00	1,950,000.00	
Të ardhura nga qiratë			0.00	0.00	
Të ardhura nga buxheti lokal		30,000.00	30,000.00	50,000.00	
Të ardhura nga ndihma e parë		300,000.00	300,000.00	300,000.00	
Donacione dhe sponsorizime		200,000.00	200,000.00	300,000.00	
Të ardhura nga KKR	4,000,000.00	550,000.00	4,550,000.00	4,600,000.00	
Nga regjistrimi i veturave	4.000.000,00		4.000.000,00	4,000,000.00	
Nga projekte			0.00	0.00	
Dhurimi i gjakut		550,000.00	550,000.00	500,000.00	
Fond për zhvillim dhe projekte të KKR		0.00	0.00	100,000.00	
Të ardhura nga kamata			0.00	0.00	
Të ardhura nga anëtarësia		120,000.00	120,000.00	150,000.00	
Të ardhura tjera		100,000.00	100,000.00	150,000.00	
Të ardhura nga shërbime tjera			0,00	0,00	
GJITHSEJ TË ARDHURA	4.000.000.00	3.700.000.00	7.700.000.00	7.500.000.00	

HARXHIME			Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
RROGA DHE KOMPENSIME	1,600,000.00	1,200,000.00	2,800,000.00	2,630,000.00	36.36
Rroga bruto	1,600,000.00	1,100,000.00	2,700,000.00	2,500,000.00	
Kompensim për pushim vjetor		100,000.00	100,000.00	80,000.00	
Çmime jubilarë			0.00	50,000.00	
Kompensime për pension			0.00	0.00	
Pagesa tjera			0.00	0.00	
HARXHIME MATERIALE	305,000.00	325,000.00	630,000.00	650,000.00	8.18
HARXHIME DITORE PËR UDHËTIM					
Mëditje në vend			0.00	0.00	
Mëditje për udhëtime jashtë vendit			0.00	0.00	

RRYMË E HARXHUAR					
Energji elektrike	30,000.00	30,000.00	60,000.00	90,000.00	
Harxhime për ujë	5,000.00	5,000.00	10,000.00	10,000.00	
Mbeturina	5,000.00	5,000.00	10,000.00	10,000.00	
Ngrohje	30,000.00	30,000.00	60,000.00	0.00	

KOMUNIKIM DHE TRANSPORT					
Posta		5,000.00	5,000.00	5,000.00	
Telefon	40,000.00	40,000.00	80,000.00	80,000.00	
Internet			0.00	0.00	
Karburant	15,000.00	15,000.00	30,000.00	35,000.00	
Harxhime për regjistrim të veturave	10,000.00	10,000.00	20,000.00	20,000.00	
Harxhime tjera për transport (pagesa rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)	5,000.00	5,000.00	10,000.00	10,000.00	

	Buxhet 2026		Buxhet 2025		%
MATERIALE					
Material zyreje	25,000.00	20,000.00	45,000.00	45,000.00	
Abonim për revista			0.00	0.00	
Pije dhe artikuj ushqimor	5,000.00	5,000.00	10,000.00	10,000.00	
Pajisje për higjienë	5,000.00	5,000.00	10,000.00	10,000.00	
Pagesa për reprezentacion	5,000.00	5,000.00	10,000.00	30,000.00	
Materiale tjera	10,000.00	30,000.00	40,000.00	40,000.00	
MIRËMBAJTJE RJEDHËSE					
Riparim dhe mirëmbajtje të veturave	15,000.00	25,000.00	40,000.00	30,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të pajisjeve	15,000.00	15,000.00	30,000.00	30,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të ndërtesës	15,000.00	15,000.00	30,000.00	40,000.00	
Mirëmbajtje të softuerit dhe harduerit	10,000.00	10,000.00	20,000.00	20,000.00	
SHËRBIME TJERA TË KONTRAKTUARA					
Shërbime avokati			0.00	0.00	
Shërbime intelektuale (ligjërues, konsulentë)			0.00	0.00	
Shërbime financiare (marrëveshje në vepër, shërbime konsultuese etj)	0.00	0.00	0.00	0.00	
Provizion bankar	20,000.00	10,000.00	30,000.00	35,000.00	
Sigurim i pronës dhe të të punësuarve	15,000.00	15,000.00	30,000.00	50,000.00	
Shërbime tjera	25,000.00	25,000.00	50,000.00	50,000.00	
HARXHIME FUNKCIONALE	1,615,000.00	2,175,000.00	3,790,000.00	3,770,000.00	49.23
VEPRIMTARI					
Organizim dhe zhvillim					
Seanca e Bordit drejtues	50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00	
Kuvendi OKK K/KQSH	70,000.00	80,000.00	150,000.00	250,000.00	
Informim dhe komunikim	80,000.00	70,000.00	150,000.00	120,000.00	
Diseminim	80,000.00	100,000.00	180,000.00	150,000.00	
Veprimtaria shëndetësore edukative	100,000.00	120,000.00	220,000.00	250,000.00	
Ndihma e parë	100,000.00	350,000.00	450,000.00	430,000.00	
Dhurimi i gjakut	80,000.00	220,000.00	300,000.00	330,000.00	
Veprimtaria Sociale-humanitare	200,000.00	450,000.00	650,000.00	630,000.00	
Shërbimi kërkesë			0.00	0.00	
Marketing	50,000.00	70,000.00	120,000.00	80,000.00	
Financa	60,000.00	40,000.00	100,000.00	80,000.00	
Fatkeqësi (minimum 5% nga të ardhurat në baza të regjistrimit të veturave)	400,000.00	150,000.00	550,000.00	600,000.00	
Bashkëpunim ndërkombëtar	5,000.00	15,000.00	20,000.00	20,000.00	
Të rinjtë	250,000.00	400,000.00	650,000.00	600,000.00	
MJETE TË PËRCJELLURA					
Transfere deri te organizatat bazë të KK		60,000.00	60,000.00	40,000.00	
Kotizim për KKR MV	90,000.00		90,000.00	90,000.00	
HARXHIME KAPITALE	480,000.00	0.00	480,000.00	450,000.00	6.23
BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRË					
Blerje të mobiljeve për zyrë	50,000.00	0.00	50,000.00	80,000.00	
Blerje të pajisjeve për IT dhe të tjera	80,000.00	0.00	80,000.00	70,000.00	
BLERJE TË AUTOMJETEVE					
Blerje të veturave			0.00	0.00	
MIRËMBAJTJE THEMELORE DHE SPECIALE					
Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore	350,000.00	0.00	350,000.00	300,000.00	
GJITHSEJ HARXHIME	4.000.000.00	3.700.000.00	7.700.000.00	7.500.000.00	100.00



KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ORGANIZATA KOMUNALE KISELLA VODË

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Organizata Komunale Kisella Vodë zhvillon aktivitete në territorin e pesë njësive lokale të vetëqeverisjes – Kisella Vodë, Aerodrom, Sopishte, Studen dhe Zelenikovë, të cilat kanë mbi 160,000 banorë, 22 shkolla fillore dhe 15 degë, 7 shkolla të mesme, dy shoqata pensionistësh, institucione dhe kompani nga sektori korporativ. Territori është kompleks, me mjedise urbane dhe rurale, të mbushura me dallime ekonomike dhe sociale, ku jetojnë komunitete të ndryshme etnike. Si një organizatë me traditë të gjatë në promovimin e humanizmit, solidaritetit dhe ndihmës së ndërsjellë, mbetet e përkushtuar ndaj aktiviteteve të saj edhe në vitin që vjen. Programi ynë synon, përmes aktiviteteve konkrete dhe të arsyeshme, të kontribuojë në përmirësimin e kushteve të jetesës në komunitetet ku veprojmë, ndërsa përmes edukimit të anëtarëve dhe vullnetarëve sigurojmë zbatimin efektiv dhe efikas të tij. Viti 2026 është vit zgjedhor për organizatën. Mbështetja nga Zyra Qendrore dhe Kryqi i Kuq i Qytetit të Shkupit do të vazhdojë pandërprerë edhe gjatë vitit që vjen.

Prioritetet:

- Forcimi i kapaciteteve të organizatës përmes rritjes së numrit të anëtarëve dhe vullnetarëve të rinj;
- Aktivitetet e fokusuar në mbështetjen e familjeve në nevojë;
- Përgatitje për përballimin e sfidave të ndryshmeve klimatike.

Veprimtaria sociale-humanitare

Përmes realizimit të aktiviteteve socio-humanitare do të sigurojmë ndihmë dhe mbështetje për individët dhe familjet nga kategoritë socialisht të cënueshme, me qëllim përmirësimin e dinjitetit njerëzor dhe kushteve të jetesës. Në këtë drejtim, në përputhje me kapacitetet dhe burimet tona, planifikojmë të ofrojmë mbështetje për 300 deri 350 familje dhe individë, përmes dhurimit të pako ushqimore, artikujve higjienikë dhe veshmbathjeve. Edhe në vitin që vjen, do të shënojmë “Javën e Solidaritetit” dhe fushatën me rastin e “Javës kundër Urisë” në bashkëpunim me shkollat dhe sektorin korporativ. Do të organizojmë dhe realizojmë aktivitete me rastin e “Javës së Kujdesit për

të Moshuarit” me vizita në shtëpitë e të moshuarve, me qëllim të përfshirjes sociale të tyre. Do të shënojmë gjithashtu “Ditën Evropiane kundër Trafikimit të Personave” duke organizuar dhjetë ligjërata edukative në shkolla, me përfshirje të mbi 150 nxënësve dhe mësuesve, për të rritur ndërgjegjësimin e nxënësve mbi pasojat e këtij fenomeni. Bashkëpunimi me Shoqatat e Pensionistëve vazhdon edhe në vitin 2026 me të njëjtin ritëm. Angazhimi ynë do të përqendrohet gjithashtu në identifikimin dhe evidentimin e kategorive të cenueshme të individëve dhe familjeve.

Aktivitete shëndetësore-parandaluese

Aktivitetet shëndetësore-parandaluese kanë për qëllim përmirësimin dhe avancimin e shëndetit të popullatës. Përmes realizimit të ligjëratave edukative shëndetësore, shpërndarjes së materialeve edukative dhe kontrolleve shëndetësore do të kontribuojmë në rritjen e vetëdijes për parandalimin e sëmundjeve infektive. Me këto aktivitete do të përfshihen rreth 3,000 persona, përfshirë nxënës, mësues, shoqata qytetare, shoqata pensionistësh, punonjës në sektorin korporativ dhe institucione. Do të realizojmë aktivitete për matjen e sheqerit në gjak dhe të presionit të gjakut në bashkëpunim me Shoqatat e Pensionistëve Kiselë Vodë dhe Aerodrom, ku do të përfshihen më shumë se 700 pensionistë dhe 300 punonjës të shkollave dhe institucioneve. Në bashkëpunim me autoritetet lokale, do të vazhdojmë implementimin e aktiviteteve për lehtësimin e pasojave nga

valët e nxehtësisë gjatë periudhës së verës. Do të organizohen ligjërata dhe publikime në rrjetet sociale mbi sëmundjet kardiovaskulare, sëmundjet e varësisë, tuberkulozin, higjienën orale dhe dentare me ushqyerje të duhur, si dhe ligjërata të tjera shëndetësore-parandaluese. Edukatorët bashkëmoshatarë do të mbajnë të paktën 10 ligjërata mbi higjienën në shkolla dhe kopshte, duke përfshirë rreth 200 fëmijë.

Dhurimi i gjakut

Si një segment i aktivitetit të organizatës, dhurimi i gjakut do të fokusohet në rritjen e numrit të dhuruesve të gjakut. Aktivitetet do të jenë të orientuara drejt promovimit të dhurimit të gjakut, rekrutimit dhe motivimit të dhuruesve të rinj në nivel lokal, si dhe organizimit të aksioneve të dhurimit të gjakut në ambiente të reja. Vullnetarët tanë në vitin 2026 do të marrin pjesë në seminare edukative për motivimin dhe angazhimin e dhuruesve të rinj të gjakut. Rekrutimi i dhuruesve nga shkollat e mesme do të përbëjë një prioritet në punën tonë. Gjatë periudhës së verës do të organizohen aksione shtesë të dhurimit të gjakut dhe aksione me thirrje të veçantë. Sipas Planit Vjetor Integruar për aksionet e dhurimit të gjakut, do të organizohen mbi 50 aksione, ku planifikohet të sigurohen rreth 3,600 njësi gjaku. Dhënia e mirënjohjeve dhe çmimeve jubile të dhuruesve të shquar, institucioneve dhe shkollave do të realizohet me rastin e 17 marsit – Ditës së dhuruesve të gjakut.





Ndihma e parë

Në trajnimet, edukimet dhe promovimet për ndihmën e parë për nxënës, mësues dhe grupe të tjera të synuara do t'i kushtohet vëmendje e veçantë. Si rezultat i kushteve globale të punës dhe jetesës, gjithnjë e më shumë jemi të ekspozuar ndaj lëndimeve të ndryshme. Dhënia e ndihmës së parë në mënyrë të menjëhershme dhe të përshtatshme ndihmon në zvogëlimin e pasojave nga lëndimet, pavarësisht se ku ndodhin ato. Gjatë vitit, organizata komunale do të sigurojë mbështetje mjekësore në ngjarje sportive, manifestime kulturore, aktivitete të shoqatave qytetare dhe kudo ku paraqitet nevoja për këtë. Ndihma e parë dhe ngritja e vetëdijes për rëndësinë e saj si aftësi kanë një rol të veçantë. Shënimi i Ditës Botërore të Ndhmës së Parë do të organizohet dhe do të mbahet në përputhje me udhëzimet dhe rekomandimet e Zyrës Qendrore dhe të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit. Në vitin 2026 do të organizohet gara komunale e ndihmës së parë për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme, me pjesëmarrje të më shumë se 20 ekipeve. Ekipet më të mira nga shkollat fillore do të marrin pjesë në garën e ndihmës së parë në organizim të Kryqit të Kuq të Qytetit të Shkupit, ndërsa ekipi më i mirë nga shkollat e mesme do të përfaqësohet në garën rajonale nga ndihma e parë.

Diseminimi dhe informimi

Në kuadër të aktiviteteve programore të organizatës, i kushtojmë vëmendje të veçantë diseminimit, përkatesisht përhapjes së idesë së Kryqit të Kuq, historisë së tij, strukturës dhe fushave të veprimit. Planifikojmë të mbajmë më shumë se 50 ligjërata në shkolla, institucione, shoqata dhe në sektorin korporativ. Zbatimi i programit PVH do të realizohet përmes përgatitjes së 4 deri në 6 projekteve të vogla në nivel lokal, trajnimit dhe pjesëmarrjes aktive të 30 vullnetarëve të rinj, me ç'rast do të kontribuojmë në përmirësimin e kushteve të punës dhe jetesës për grupet e caktuara të synuara. Programi PHV paraqet një mjet dhe mundësi të shkëlqyer për të tërhequr dhe mbajtur anëtarë e vullnetarë të rinj në organizatë, gjë për të cilën jemi veçanërisht krenarë. Diseminimi do të realizohet gjithashtu përmes shpërndarjes së fletushkave informuese në shkolla fillore dhe të mesme, institucione, shoqata si dhe përmes publikimeve në media. Për aktivitete që i zbaton organizata komunale, informacionet do të ndahen përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram), faqes sonë të internetit dhe mediave. Informimi i vazhdueshëm është detyrim dhe mundësi për qytetarët që të njihen me punën tonë, duke na bërë më të dukshëm dhe më lehtë të identifikueshëm në komunitetet ku veprojmë.



Të rinjtë

Si pjesë përbërëse e organizatës, të rinjtë japin një kontribut të veçantë në realizimin e aktiviteteve programore. Qëllimi i programit është të motivojë të rinjtë vullnetarë të marrin pjesë në aktivitete humanitare, edukative, mjedisore dhe të tjera, përmes të cilave do të zhvillojnë vlera si solidariteti, empatia, përgjegjësia dhe zhvillimi personal. Programi zbatohet vazhdimisht gjatë gjithë vitit. Segmentet e veprimtarisë për të rinjtë përfshijnë: edukime për ndihmën e parë, promovim i vlerave humane, aktivitetet lidhur me shëndetin mendor, edukime shëndetësore dhe parandaluese për bashkëmoshatarët, aksione mjedisore dhe promovim i ndërgjegjësimit ekologjik, forma rinore të bashkëbisedimit, punëtori dhe ditë sportive. Rezultatet e pritura për organizatën janë rritje të numrit të të rinjve vullnetarë aktivë me aftësi të zhvilluara lidhshipi dhe komunikimi, përmirësim i dukshmërisë së të rinjve brenda komunitetit. Programi është fleksibël dhe do të përshtatet me nevojat dhe iniciativat aktuale. Të rinjtë gjithashtu do të marrin pjesë në kampin veror rinor të organizuar nga Kryqi i Kuq i Maqedonisë së Veriut.

Partnerë dhe bashkëpunim

Bashkëpunimi dhe mbështetja nga partnerët dhe bashkëpunëtorët tanë kanë një rëndësi të veçantë për organizatën. Në vitin 2026, Kryqi i Kuq i Maqedonisë së Veriut – Organizata Komunale Kisella Vodë do të vazhdojë me iniciativë për të krijuar bashkëpunim partnerësh me organizata dhe institucione të reja. Suksesi në zbatimin e aktiviteteve programore në një pjesë varet nga bashkëpunimi i mirë dhe i vazhdueshëm me vetëqeverisjet lokale, institucionet, shkollat, shoqatat dhe sektori korporativ.

Aktivitetet e Organizatës Komunale dhe të të rinjve pritet të mbështeten nga një numër i madh donatorësh si: DTU-Magroni, Bitolska Mlekarnica, Vinçini, Leona, Alegra, Tineks dhe Vero Market, Kompania Velkoski, Kompania VATO-DOO, Fabrika e Cimentos Usje-Titan, Euro Kuvajt, Hekurudhat e Maqedonisë dhe MAKSTIL, Qendra Tregtare Kapitol Mall, Shoqatat e pensionistëve Kisella Vodë dhe Aerodrom, Kisha Shën Atanasij në Usje, Kisha Shën Pjetri dhe Pavli në Lisicë të epërme, Kisha Shën Petka në Kisella Vodë



BUXHETI

TË KRYQIT TË KUQ KISELLA VODË PËR VITIN 2026

	Të ardhura nga Ligji për KKR	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
HARXHIME	4,180,000.00	3,120,000.00	7,300,000.00	7,100,000.00	0.00
HARXHIME PËR RROGA DHE KOMPENSIME	1,590,000.00	1,090,000.00	2,680,000.00	2,530,000.00	36.71
HARXHIME MATERIALE	680,000.00	454,000.00	1,134,000.00	1,124,000.00	15.53
HARXHIME FUNKSIONALE	1,680,000.00	1,706,000.00	3,386,000.00	3,346,000.00	46.38
HARXHIME KAPITALE	50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00	1.37
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	3,300,000.00	7,300,000.00	7,100,000.00	100.00
DALLIMI					00.00

TË ARDHURA	Të ardhura nga Ligji për KKR	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
Mjete të përcjellura nga të ardhurat shtesë nga viti i kaluar		1,200,000.00	1,200,000.00	1,100,000.00	
Të ardhura nga qiratë			0.00	0.00	
Të ardhura nga buxheti lokal		200,000.00	200,000.00	130,000.00	
Të ardhura nga ndihma e parë		300,000.00	300,000.00	300,000.00	
Donacione dhe sponsorizime		190,000.00	190,000.00	190,000.00	
Të ardhura nga KKR	4,000,000.00	1,130,000.00	5,130,000.00	5,130,000.00	
Nga regjistrimi i veturave	4,000,000.00		4,000,000.00	4,000,000.00	
Nga projekte		280,000.00	280,000.00	280,000.00	
Dhurimi i gjakut		600,000.00	600,000.00	600,000.00	
Fond për zhvillim dhe projekte të KKR		250,000.00	250,000.00	250,000.00	
Të ardhura nga kamata			0.00	0.00	
Të ardhura nga anëtarësia		180,000.00	180,000.00	180,000.00	
Të ardhura tjera		100,000.00	100,000.00	70,000.00	
Të ardhura nga shërbime tjera			0.00	0.00	
GJITHSEJ TË ARDHURA	4,000,000.00	3,300,000.00	7,300,000.00	7,100,000.00	

HARXHIME			Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
RROGA DHE KOMPENSIME	1,590,000.00	1,090,000.00	2,680,000.00	2,530,000.00	
Rroga bruto	1,590,000.00	1,010,000.00	2,600,000.00	2,400,000.00	
Kompensim për pushim vjetor		80,000.00	80,000.00	80,000.00	
Çmime jubilarë			0.00	50,000.00	
Kompensime për pension			0.00	0.00	
Pagesa tjera			0.00	0.00	
HARXHIME MATERIALE	680,000.00	454,000.00	1,134,000.00	1,124,000.00	
HARXHIME DITORE PËR UDHËTIM					
Mëditje në vend			0.00	0.00	
Mëditje për udhëtime jashtë vendit			0.00	0.00	
RRYMË E HARXHUAR					
Energji elektrike			0.00	0.00	
Harxhime për ujë			0.00	0.00	
Mbeturina			0.00	0.00	
Ngrohje			0.00	0.00	
KOMUNIKIM DHE TRANSPORT					
Posta			0.00	0.00	
Telefon	80,000.00	50,000.00	130,000.00	130,000.00	
Internet	20,000.00		20,000.00	20,000.00	
Karburant	145,000.00	35,000.00	180,000.00	180,000.00	
Harxhime për regjistrim të veturave	30,000.00	10,000.00	40,000.00	40,000.00	
Harxhime tjera për transport (pagesa rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)	30,000.00	20,000.00	50,000.00	50,000.00	

	Buxhet 2026		Buxhet 2025	%	
MATERIALE					
Material zyreje	30,000.00	50,000.00	80,000.00	80,000.00	
Abonim për revista			0.00	0.00	
Pije dhe artikuj ushqimor		40,000.00	40,000.00	40,000.00	
Pajisje për higjienë	50,000.00	20,000.00	70,000.00	70,000.00	
Pagesa për reprezentacion	20,000.00		20,000.00	20,000.00	
Materiale tjera		30,000.00	30,000.00	30,000.00	
MIRËMBAJTJE RJEDHËSE					
Riparim dhe mirëmbajtje të veturave	30,000.00		30,000.00	30,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të pajisjeve	20,000.00	20,000.00	40,000.00	40,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të ndërtesës	20,000.00	10,000.00	30,000.00	30,000.00	
Mirëmbajtje të softuerit dhe harduerit	30,000.00	20,000.00	50,000.00	50,000.00	
SHËRBIME TJERA TË KONTRAKTUARA					
Shërbime avokati			0.00	0.00	
Shërbime intelektuale (ligjërues, konsulentë)	20,000.00	20,000.00	40,000.00	40,000.00	
Shërbime financiare (marrëveshje në vepër, shërbime konsultuese etj)	25,000.00	25,000.00	50,000.00	50,000.00	
Provizion bankar	10,000.00	10,000.00	20,000.00	20,000.00	
Sigurim l pronës dhe të të punësuarve		24,000.00	24,000.00	24,000.00	
Shërbime tjera	10,000.00	10,000.00	20,000.00	20,000.00	
HARXHIME FUNKCIONALE	1,680,000.00	1,706,000.00	3,386,000.00	3,346,000.00	
VEPRIMTARI					
Organizim dhe zhvillim					
Seanca e Bordit drejtues	100,000.00	40,000.00	140,000.00	140,000.00	
Kuvendi I OKKK/KKQSH	100,000.00	10,000.00	110,000.00	110,000.00	
Informim dhe komunikim	50,000.00	80,000.00	130,000.00	120,000.00	
Diseminim	100,000.00	210,000.00	310,000.00	300,000.00	
Veprimtaria shëndetësore edukative	150,000.00	170,000.00	320,000.00	315,000.00	
Ndihma e parë	300,000.00	200,000.00	500,000.00	500,000.00	
Dhurimi i gjakut		320,000.00	320,000.00	320,000.00	
Veprimtaria Sociale-humanitare	250,000.00	230,000.00	480,000.00	470,000.00	
Shërbimi kërkesë			0,00	0,00	
Marketing			0,00	0,00	
Financa		80,000.00	80,000.00	80,000.00	
Fatkeqësi (minimum 5% nga të ardhurat në baza të regjistrimit të veturave)	400,000.00	200,000.00	600,000.00	600,000.00	
Bashkëpunim ndërkombëtar			0,00	0,00	
Të rinjtë	140,000.00	166,000.00	306,000.00	301,000.00	
MJETE TË PËRCJELLURA					
Transfere deri te organizatat bazë të KK			0,00	0,00	
Kotizim për KKRMV	90.000,00		90.000,00	90.000,00	
HARXHIME KAPITALE	50,000.00	50,000.00	100,000.00	100,000.00	
BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRË					
Blerje të mobiljeve për zyrë			0,00	0,00	
Blerje të pajisjeve për IT dhe të tjera	25,000.00	25,000.00	50,000.00	50,000.00	
BLERJE TË AUTOMJETEVE					
Blerje të veturave			0.00	0.00	
MIRËMBAJTJE THEMELORE DHE SPECIALE					
Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore	25,000.00	25,000.00	50,000.00	50,000.00	
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	3,300,000.00	7,300,000.00	7,100,000.00	100.00



KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ORGANIZATA KOMUNALE QENDËR

Hyrje

Viti 2026 paraqet një periudhë të rëndësishme për organizatën për shkak të zhvillimit të procesit zgjedhor në të gjitha nivelet e strukturës organizative. Në këto rrethana, programi i punës është i orientuar drejt sigurimit të vazhdimësisë së aktiviteteve, forcimit të kapaciteteve institucionale dhe garantimit të një procesi zgjedhor transparent, në përputhje me Statutin dhe rregulloret e Kryqit të Kuq të RMV-së.

Qëllimi kryesor është të sigurohet funksionimi efektiv i organizatës gjatë ciklit zgjedhor, ruajtja e parimeve të neutralitetit, paanshmërisë dhe unitetit, si dhe mbajtja e një shkalle të lartë operativiteti dhe besimi në publik.

Prioritetet për vitin 2026

1. Sigurimi i një procesi zgjedhor të suksesshëm dhe transparent dhe forcimi i kapaciteteve institucionale

- Zhvillimi i zgjedhjeve në përputhje me Statutin, rregulloret zgjedhore dhe kalendarin e aktiviteteve.

- Sigurimi i sesioneve edukative dhe informuese për kandidatët dhe anëtarët e organizatës.
- Garantimi i mundësive të barabarta dhe përfaqësimit gjinor në proceset zgjedhore.
- Trajnime për lidhshmëri, menaxhim dhe llogaridhënie për strukturat e sapozgjedhura.
- Forcimi i sistemeve për transparencë dhe llogaridhënie financiare.
- Promovimi i vlerave dhe parimeve të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.

2. Mbajtja e aktiviteteve të rregullta programore

- Vazhdimësia në programet e veprimtarisë socio-humanitare, mbështetja e kategorive të cënueshme dhe personave në rrezik social.
- Zbatimi i aktiviteteve për edukim shëndetësor dhe parandalues, dhurim gjaku dhe mbështetje psiko-sociale.
- Aktivitete për të rinjtë dhe vullnetarët, me fokus

në pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin zgjedhor dhe në programet e rregullta.

- Zbatimi i aktiviteteve në kuadër të përgatitjes dhe reagimit **ndaj fatkeqësive**, si dhe mbështetjes humanitare në situata krize.

3. Komunikimi dhe partneritetet

- Ruajtja dhe zhvillimi i bashkëpunimit me institucionet shtetërore, vetëqeverisjet lokale dhe partnerë të tjerë.
- Rritja e dukshmërisë së organizatës përmes kanaleve mediatike dhe të komunikimit digjital.
- Forcimi i besimit të publikut përmes llogaridhënies dhe raportimit transparent.

1. Sigurimi i një procesi zgjedhor të suksesshëm dhe transparent

Sipas Rregullave për organizimin e zgjedhjeve të Kryqit të Kuq të RMV-së, Organizata Komunale Qendër, gjatë gjysmës së parë të vitit 2026, do të zhvillojë procesin zgjedhor për strukturat drejtuese të organizatës për periudhën mandatore 2026–2030. Procedura parashikon përfshirjen e plotë të anëtarësisë, vullnetarëve dhe shërbimit profesional të organizatës, si dhe respektimin e rekomandimeve të Zyrës Qendrore të Kryqit të Kuq të RMV-së për organizimin e procesit zgjedhor.



- Pas zbatimit të procesit zgjedhor, Organizata Komunale Qendër do të përkushtohet në organizimin e trajnimeve për lidhshmëri, menaxhim dhe llogaridhënie për strukturat e sapozgjedhura. Janë planifikuar të paktën 5 trajnime mbi këto tema, në të cilat do të përfshihen anëtarët e strukturave të sapozgjedhura nga të gjitha nivelet e vendosjes organizative në nivel komunal.
- Promovimi i misionit dhe parimeve bazë të Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe mbetet një angazhim i përhershëm i organizatës në drejtim të diseminimit të njohurive tek popullata e gjerë dhe grupet e rrezikuara qëllimore. Përveç sesioneve klasike të shpërndarjes së njohurive që praktikohen në Klubin e të Rinjve dhe në institucionet arsimore në territorin e komunës Qendër, këtë vit do të përkushtohet veçanërisht vëmendje tek trajnimi i anëtarëve të rinj të strukturave udhëheqëse të organizatës, të cilët do të dalin nga zbatimi i procesit zgjedhor për periudhën mandatore 2026–2030.
- Gjatë vitit është planifikuar hartimi i projekteve, ku përmes bashkëpunimit të partneritetit me sektorin civil dhe vetëqeverisjen lokale, do të përdoret mundësia për aplikim në thirrjet publike që do të jenë në dispozicion, si dhe aplikim me projekte në Fondin për Zhvillim dhe projektet e Kryqit të Kuq të RMV-së. Në këtë drejtim, do të punohet intensivisht për forcimin e kapaciteteve të shërbimit profesional dhe të vullnetarëve për trajnim dhe specializim në fushën e mobilizimit të fondeve.

2. Mbajtja e aktiviteteve të rregullta programore Veprimtari sociale-humanitare

Edhe gjatë vitit të ardhshëm, veprimtaria sociale-humanitare do të mbetet e përqendruar në mbrojtjen e dinjitetit njerëzor, uljen e rreziqeve sociale dhe mbështetjen e kategorive më të cenueshme të popullsisë.

Në kuadër të kalendarit tradicional të aktiviteteve të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut, do të vazhdojë realizimi i iniciativave kryesore humanitare – Java e Solidaritetit dhe Java e Urisë. Përmes partneriteteve me kompani, institucione dhe qytetarë përgjegjës socialisht, do të sigurohen burime për përgatitjen e pakove ushqimore dhe mjeteve higjienike, të cilat do të shpërndahen te familjet më të rrezikuara dhe përdoren si mbështetje në rast të gjendjeve të krizës ose fatkeqësive natyrore.

Përveç mbështetjes direkte humanitare, do të kushtohet vëmendje edhe promovimit të solidaritetit dhe empatisë si vlera themelore njerëzore. Përmes aktiviteteve edukative dhe vullnetare, komuniteti do të inkurajohet drejt një përfshirjeje më të madhe dhe kujdesi për ata që jetojnë në rrezik social.

Do të vihet një theks i veçantë në përfshirjen e personave me aftësi të kufizuara, përmes organizimit të aktiviteteve që do t'u mundësojnë një integrim më të mirë social dhe pjesëmarrje aktive në komunitet. Me personat e moshës së tretë, në partneritet me Shoqatën e Pensionistëve të Komunës Qendër, do të vazhdohet bashkëpunimi i rregullt dhe zhvillimi i programeve që ndjekin interesat dhe nevojat e tyre, duke marrë parasysh aspektet e ndryshme të cënueshmërisë së tyre.

Kanalet e komunikimit tash të vënduara me grupet qëllimore do të vazhdojnë të përdoren aktivisht për të afruar shërbimet dhe aktivitetet tona te komuniteti. Të gjitha komplimentet, sugjerimet dhe ankesat që mblihen si informacione të kthyer do të shërbejnë si bazë për përmirësimin e mëtejshëm të cilësisë dhe efektivitetit të programeve tona. Në këtë mënyrë, aktivitetet do të planifikohen edhe më saktë – në përputhje me nevojat reale dhe prioritetet e komunitetit.

Edukimi shëndetësor parandalues, dhurimi i gjakut dhe mbështetja psikosociale

Programi shëndetësor-parandalues do të vazhdojë të realizohet përmes edukimit, përgatitjes dhe shpërndarjes së materialeve informative, mobilizimit të grupeve të synuara dhe forcimit të kapaciteteve lokale. Theksi do të vihet në përmirësimin e zakoneve shëndetësore, si dhe në uljen e stigmatizimit dhe diskriminimit ndaj kategorive të cënueshme të popullsisë. Të gjitha aktivitetet do të jenë të harmoni-

zuara me kalendarin tradicional të aktiviteteve të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut.

- Është planifikuar realizimi i 50 edukimeve ndërmoshatare në shkollat fillore, 25 punëtori në shkollat e mesme dhe 10 punëtori në Klubin e të Rinjve, me përfshirjen e më shumë se 70 vullnetarëve. Gjithashtu, në vazhdimësi është planifikuar të vazhdojë bashkëpunimi me Shoqatën e Pensionistëve të Komunës Qendër, përmes aktiviteteve për matjen e sheqerit në gjak dhe presionit të gjakut në tetë degët e shoqatës, si dhe përmes punëtorive edukative për parandalimin shëndetësor dhe ligjëratave të caktuara mbi tema shëndetësore të nevojshme për personat e moshës së tretë. Do të organizohen punëtori me mësuesit e shkollave fillore mbi temën „Edhe ndihmuesve u duhet ndihmë“, me qëllim kujdesin për shëndetin mendor të mësuesve dhe parandalimin e rraskapitjes profesionale. Përmes këtyre aktiviteteve, rreth 200 mësues do të përmirësojnë njohuritë e tyre për vetë-ndihmën dhe parandalimin e rraskapitjes profesionale. Sipas nevojës, punëtori të tilla do të mbahen edhe në institucione të tjera me personel mjekësor, prindër të fëmijëve me nevoja të veçanta etj.

Ndihma e parë

Gjatë periudhës së ardhshme, aktivitetet për ndihmën e parë do të vazhdojnë të zhvillohen si një segment i rëndësishëm i promovimit shëndetësor. Qëllimi është përmirësimi i vazhdueshëm i modeleve të trajnimit dhe përmbajtjeve



programore, të përshtatura për grupe të ndryshme moshe dhe grupe të synuara, në përputhje me rekomandimet e shoqatës nacionale. Aktivitetet e filluara në vitin 2022 përmes fushatës „Ndhimja e parë shpëton jetë“ do të vazhdojnë me realizimin e trajnimeve bazë për ndihmën e parë në bashkëpunim me Komunën Qendër, në tetë shkolla fillore në territorin e saj. Parashikohen gjithashtu trajnime rifreskuese për personelin mësimor, si dhe përfshirja e 600 deri 700 nxënësve nga klasa e tetë dhe e nëntë. Trajnimet do të realizohen sipas një moduli të veçantë, të fokusuar te lëndimet që ndodhin më shpesh në shkolla.

Gjatë vitit 2026 pritet përmirësimi i trajnimeve për ndihmën e parë për shoferët, që do të kontribuojë në përmirësimin e reputacionit dhe stabilitetit financiar të organizatës.

Është planifikuar që në prill 2026 të mbahet një garë komunale nga ndihma e parë me pjesëmarrjen e 13 deri 15 ekipeve në kategorinë e të rinjve. Përmes këtij aktiviteti, rreth 100 nxënës do të trajnohen për aftësitë bazë nga ndihma e parë.

Si shtesë, do të zhvillohen trajnime për rifreskimin e njohurive të demonstruesve ekzistues të ndihmës së parë, të cilët do të udhëheqin trajnimet në shkolla dhe do të punojnë me nxënësit për garat.

Dhurimi i gjakut

Parimet themelore të vullnetarizmit, anonimatit dhe falasitetit mbeten baza e zbatimit të suksesshëm të programit të dhurimit të gjakut. Në vitin 2026, parashikohet të mblidhen **2260 njësi gjaku** përmes **85 aksionesh**, ndërsa me organizim të mirë pritet të arrihen edhe mbi **3500 njësi**. Planifikohet organizimi i së paku tre aksioneve të reja të dhurimit të gjakut në institucione dhe organizata ku këto aktivitete më parë nuk janë realizuar ose janë ndërprerë.

Theksi do të vihet në rritjen e ndërgjegjësimit publik për rëndësinë e dhurimit vullnetar të gjakut dhe zhvillimin e modeleve të reja motivuese për qytetarët që dhurojnë gjak. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet tërheqjes së dhuruesve të rinj, kryesisht mes studentëve dhe nxënësve të shkollave të mesme.

Është planifikuar përmirësimi i bashkëpunimit me Bashkësitë Studentore dhe Rektoratet e UKIM-it lidhur me organizimin e një tryeze të rrumbullakët mbi temën „Dhurimi i gjakut – akti më i lartë i humanizmit“, me pjesëmarrjen e mjekëve të transfuzionit dhe dhuruesve me përvojë të gjatë si motivues. Nevojitet trajnim i motivuesve të rinj për dhurim gjaku, të cilët do të përfshihen në trajnime motivuese në shkolla, me qëllim rritjen e numrit të dhuruesve në shkollat e mesme.

Aktivitetet e lidhura me ndarjen e mirënjohjeve për dhuruesit e gjakut do të organizohen edhe në vitin 2026, me qëllim



vlerësimin e dhuruesve për humanizmin dhe përgjegjësinë e tyre shoqërore.

Të rinjtë

Aktivitetet për të rinjtë vullnetarë gjatë vitit 2026 do të fokusohen në pjesëmarrjen e tyre aktive në procesin zgjedhor të Organizatës Komunale Qendër dhe në strukturat e veprimtarisë rinore, si dhe në planifikimin dhe zbatimin e programeve të rregullta. Ata padyshim përfaqësojnë fuqinë lëvizëse të aktiviteteve të Organizatës Komunale Qendër, dhe gjatë vitit të ardhshëm roli i tyre do të jetë edhe më i theksuar. Do të vazhdojmë të krijojmë mundësi të reja për vullnetarizëm dhe pjesëmarrje aktive, të përshtatura me interesat, aftësitë dhe idetë kreative të tyre. Me zhvillimin e vazhdueshëm të aftësive dhe kompetencave të tyre, programet rinore do të kontribuojnë në forcimin e komunitetit lokal dhe promovimin e vlerave humanitare.

Edukimi ndërmoshatar do të mbetet një instrument kyç për transmetimin e njohurive dhe promovimin e vlerave humane midis të rinjve. Në vitin 2026, edukatorët ndërmoshatar të trajnuar do të udhëheqin seanca në kopshte, shkolla fillore dhe të mesme, duke mbuluar tema si ndihma e parë, shëndeti mendor, lufta kundër trafikut të personave, parandalimi i sëmundjeve të varësisë, vetë-mbrojtja dhe mbrojtja në rastefatkeqësish, si dhe tema të tjera aktuale. Edukimet ndërmoshatëre do të vazhdojnë edhe për vullnetarët e Klubit

të të Rinjve, me qëllim përmirësimin e vazhdueshëm të njohurive dhe aftësive praktike të tyre.

Vullnetarët e rinj do të integrohen përmes seancave diseminative që do t'i njohin ata me historinë, vlerat dhe strukturën e Kryqit të Kuq, ndërsa më të përvojshmit do të marrin pjesë në punëtori të avancuara të fokusuar në kuptimin më të mirë të proceseve organizative dhe kontributit të Kryqit të Kuq në nivel nacional.

Programi „Kryqi i Kuq në aksion – Promovimi i vlerave humane“ do të mundësojë rekrutimin e 30 vullnetarëve të rinj, të cilët pas përfundimit të trajnimit do të realizojnë projekte të vogla, por të rëndësishme për mirëqenien e komunitetit. Këto aktivitete kanë ndikim të drejtpërdrejtë në uljen e vuajtjeve dhe mbështetjen e atyre që përballen me sfida sociale.

Punëtoritë javore të rregullta në Qendrën Ditore për persona me aftësi të kufizuara intelektuale „Pranvera“ dhe bashkëpunimi me nxënësit e Shkollës Shtetërore të Mesme për Rehabilitim dhe Arsim „Shën Naum Ohridski“ do të vazhdojnë, duke mundësuar ndërveprim, shkëmbim përvojash dhe pjesëmarrje aktive në komunitet.

Të gjitha aktivitetet do të dokumentohen dhe promovohen përmes kanaleve zyrtare të organizatës – faqes së internetit dhe rrjeteve sociale (Facebook, Instagram dhe YouTube). Promovimi i Klubit të të Rinjve do të realizohet edhe përmes ditëve të hapura, ngjarjeve publike dhe aktiviteteve në terren, duke u mundësuar të rinjve të njohin mundësitë dhe vlerat që ofron Kryqi i Kuq.

Përgatitja dhe veprimi në rast fatkeqësish

Ndryshimet në Ligjin e Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut në vitin 2019 dhe më pas nënkuptojnë detyrimin për të angazhuar më shumë për zhvillimin e kapaciteteve të organizatës në fushën e menaxhimit të fatkeqësive. Kjo do të thotë se do të vazhdojmë ngritjen e vetëdijes së publikut përmes edukimit mbi mbrojtjen dhe vetë-mbrojtjen në rast fatkeqësish, për pasojat e mundshme të tyre dhe përgatitjen për veprime të shpejta nga vullnetarët tanë, si dhe aktivitete për sigurimin e rezervave materiale dhe pajisjeve për veprim në rast fatkeqësish, si dhe investime në trajnime dhe zhvillimin e kapaciteteve të vullnetarëve të përfshirë në këto aktivitete. Gjatë vitit të ardhshëm planifikohet vazhdimi i aktiviteteve për uljen e rreziqeve nga katastrofat në 17 institucione arsimore (shkolla fillore, shkolla të mesme dhe institucione parashkollore në territorin e komunës Qendër) në bashkëpunim të drejtpërdrejtë me vetëqeverisjen lokale. Në këtë drejtim planifikohet realizimi i aktiviteteve stërvitore për simulimin e evakuimit në rast katastrofash dhe trajnime për stafin mësimor dhe teknik në institucionet arsimore.

Organizata Komunale Qendër me përfaqësuesit e saj do të jetë pjesë e Njësisë Nacionale të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut për përgjigje në rast fatkeqësish.

3. Komunikimi dhe partneritetet

Do t'i kushtohet vëmendje e veçantë forcimit të bashkëpunimit partner me vetëqeverisjen lokale të komunës Qendër, vazhdimi të bashkëpunimit me organizatat qytetare me të cilat tashmë janë nënshkruar memorandume bashkëpunimi, si dhe krijimit të kushteve për bashkëpunime të reja partneriale me qëllim uljen e ndjeshmërisë së grupeve të synuara që trajton organizata jonë. Planifikohet gjithashtu vazhdimi i bashkëpunimit me kompanitë ku funksionojnë organizata bazë të Kryqit të Kuq, të cilat përmes aktiviteteve të tyre të përgjegjësisë sociale të punonjësve marrin pjesë në realizimin e aktiviteteve tradicionale të Kryqit të Kuq të RSM në fushën e veprimtarisë sociale-humanitare.

Për një transparencë më të madhe në funksionimin e Organizatës Komunale Qendër, të gjitha aktivitetet do të dokumentohen dhe promovohen përmes rrjeteve sociale (Facebook, Instagram, kanali YouTube dhe faqja zyrtare e internetit) të Kryqit të Kuq të Republikës së Maqedonisë së Veriut – Organizata Komunale Qendër.



BUXHETI

TË KRYQIT TË KUQ QENDËR PËR VITIN 2026

	<i>Të ardhura nga Lighi për KKRM</i>	<i>Të ardhura të tjera</i>	<i>Buxhet 2026</i>	<i>Buxhet 2025</i>	<i>%</i>
HARXHIME	5,085,000.00	3,035,000.00	8,120,000.00	7,620,000.00	100.00
HARXHIME PËR RROGA DHE KOMPENSIME	1,030,000.00	1,570,000.00	2,600,000.00	2,400,000.00	32.02
HARXHIME MATERIALE	680,000.00	561,000.00	1,241,000.00	1,210,000.00	15.28
HARXHIME FUNKSIONALE	2,290,000.00	1,789,000.00	4,079,000.00	3,800,000.00	50.23
HARXHIME KAPITALE		200,000.00	200,000.00	210,000.00	2.46
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	4,120,000.00	8,120,000.00	7,620,000.00	100.00
DALLIMI					00.00

TË ARDHURA	<i>Të ardhura nga Lighi për KKRM</i>	<i>Të ardhura të tjera</i>	<i>Buxhet 2026</i>	<i>Buxhet 2025</i>	<i>%</i>
Mjete të përcjellura nga të ardhurat shtesë nga viti I kaluar		2,500,000.00	2,500,000.00	2,000,000.00	
Të ardhura nga qiratë			0.00	0.00	
Të ardhura nga buxheti lokal		70,000.00	70,000.00	70,000.00	
Të ardhura nga ndihma e parë		300,000.00	300,000.00	300,000.00	
Donacione dhe sponsorizime		190,000.00	190,000.00	190,000.00	
Të ardhura nga KKRMV	4,000,000.00	950,000.00	4,950,000.00	4,950,000.00	
Nga regjistrimi i veturave	4,000,000.00		4,000,000.00	4,000,000.00	
Nga projekte			0.00	0.00	
Dhurimi i gjakut		700,000.00	700,000.00	700,000.00	
Fond për zhvillim dhe projekte të KKRMV		250,000.00	250,000.00	250,000.00	
Të ardhura nga kamata			0.00	0.00	
Të ardhura nga anëtarësia		100,000.00	100,000.00	100,000.00	
Të ardhura tjera		200,000.00	200,000.00	200,000.00	
Të ardhura nga shërbime tjera			0.00	0.00	
GJITHSEJ TË ARDHURA	4,000,000.00	4,120,000.00	8,120,000.00	7,620,000.00	

HARXHIME			<i>Buxhet 2026</i>	<i>Buxhet 2025</i>	<i>%</i>
RROGA DHE KOMPENSIME	1,800,000.00	800,000.00	2,600,000.00	2,400,000.00	
rroga bruto	1,800,000.00	720,000.00	2,520,000.00	2,320,000.00	
Kompensim për pushim vjetor		80,000.00	80,000.00	80,000.00	
Çmime jubilarë			0.00	0.00	
Kompensime për pension			0.00	0.00	
Pagesa tjera			0.00	0.00	
HARXHIME MATERIALE	0.00	1,241,000.00	1,241,000.00	1,210,000.00	
HARXHIME DITORE PËR UDHËTIM					
Mëditje në vend			20,000.00	20,000.00	
Mëditje për udhëtime jashtë vendit			0.00	0.00	
RRYMË E HARXHUAR					
Energji elektrike		150,000.00	150,000.00	140,000.00	
Harxhime për ujë			0.00	0.00	
Mbeturina			0.00	0.00	
Ngrohje			0.00	0.00	
KOMUNIKIM DHE TRANSPORT					
Posta			0.00	0.00	
Telefon		150,000.00	150,000.00	150,000.00	
Internet			0.00	0.00	
Karburant		70,000.00	70,000.00	70,000.00	
Harxhime për regjistrim të veturave		30,000.00	30,000.00	30,000.00	
Harxhime tjera për transport (pagesa rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)		26,000.00	26,000.00	26,000.00	

		Buxhet 2026	Buxhet 2025	%	
MATERIALE					
Material zyreje		80,000.00	80,000.00	80,000.00	
Abonim për revista			0.00	0.00	
Pije dhe artikuj ushqimor		30,000.00	30,000.00	30,000.00	
Pajisje për higjienë		20,000.00	20,000.00	20,000.00	
Pagesa për reprezentacion		50,000.00	50,000.00	50,000.00	
Materiale tjera		90,000.00	90,000.00	90,000.00	
MIRËMBAJTJE RJEDHËSE					
Riparim dhe mirëmbajtje të veturave		60,000.00	60,000.00	60,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të pajisjeve		60,000.00	60,000.00	60,000.00	
Harxhime për mirëmbajtje të ndërtesës			0.00	0.00	
Mirëmbajtje të softuerit dhe harduerit		60,000.00	60,000.00	60,000.00	
SHËRBIME TJERA TË KONTRAKTUARA					
Shërbime avokati			0.00	0.00	
Shërbime intelektuale (ligjërues, konsulentë)			0.00	0.00	
Shërbime financiare (marrëveshje në vepër, shërbime konsultuese etj)		200,000.00	200,000.00	200,000.00	
Provizion bankar		25,000.00	25,000.00	24,000.00	
Sigurim i pronës dhe të të punësuarve		20,000.00	20,000.00	20,000.00	
Shërbime tjera		100,000.00	100,000.00	100,000.00	
HARXHIME FUNKCIONALE	2,000,000.00	2,079,000.00	4,079,000.00	3,800,000.00	
VEPRIMTARI					
Organizim dhe zhvillim		179,000.00	179,000.00	120,000.00	
Seanca e Bordit drejtues		100,000.00	100,000.00	100,000.00	
Kuvendi I OKK//KKQSH		100,000.00	100,000.00	60,000.00	
Informim dhe komunikim		100,000.00	100,000.00	100,000.00	
Diseminim		60,000.00	60,000.00	60,000.00	
Veprimtaria shëndetësore edukative	110,000.00	310,000.00	420,000.00	350,000.00	
Ndihma e parë	100,000.00	400,000.00	500,000.00	500,000.00	
Dhurimi i gjakut		395,000.00	395,000.00	395,000.00	
Veprimtaria Sociale-humanitare		500,000.00	100,000.00	600,000.00	
Shërbimi kërkesë			0,00	0,00	
Marketing	90,000.00		90,000.00	90,000.00	
Financa	100,000.00	70,000.00	170,000.00	100,000.00	
Fatkeqësi (minimum 5% nga të ardhurat në baza të regjistrimit të veturave)	600,000.00		600,000.00	600,000.00	
Bashkëpunim ndërkombëtar			0,00	0,00	
Të rinjtë	500,000.00	85,000.00	585,000.00	585,000.00	
MJETE TË PËRCJELLURA					
Transfere deri te organizatat bazë të KK		150,000.00	150,000.00	150,000.00	
Kotizim për KKR MV		30,000.00	30,000.00	30,000.00	
HARXHIME KAPITALE	200,000.00	0.00	200,000.00	210,000.00	
BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRË					
Blerje të mobiljeve për zyrë	100,000.00		100,000.00	100,000.00	
Blerje të pajisjeve për IT dhe të tjera	100,000.00		100,000.00	110,000.00	
BLERJE TË AUTOMJETEVE					
Blerje të veturave			0.00	0.00	
MIRËMBAJTJE THEMELORE DHE SPECIALE					
Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore			0.00	0.00	
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	4,120,000.00	8,120,000.00	7,620,000.00	100.00



KRYQI I KUQ I REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT ORGANIZATA KOMUNALE ÇAIR

Hyrje

Kryqi i Kuq i Republikës së Maqedonisë së Veriut – Organizata Komunale Çair vepron në territorin e 4 njësive lokale: Butel, Çair, Shuto Orizarë dhe Çučer-Sandevë, ku jetojnë rreth 130,000 banorë nga të gjitha kombësitë: maqedonas, shqiptarë, turq, romë, vllahë, serbë dhe boshnjakë. Diversiteti i popullsisë i ofron organizatës komunale një mundësi të veçantë për përparim, zhvillim dhe integrim.

Prioritete

- Zbatimi i ciklit zgjedhor për periudhën e mandatit 2026-2030.
- Procesi do të zhvillohet në mënyrë transparente, me përfshirje aktive të të gjithë anëtarëve dhe organeve të organizatës.
- Rritja e vetëdijes tek popullsia për të siguruar një jetë të shëndetshme dhe dinjitoze.
- Përmes aktiviteteve edukative dhe fushatave do të nxiset një ndryshim pozitiv në zakonet e jetesës dhe përgjegjësinë shoqërore.
- Mobilizimi i popullsisë për një shoqëri më gjithëpërfshirëse, të drejtë dhe kohezive.

Do të krijohen partneritete me komunitetet lokale për të forcuar solidaritetin dhe pjesëmarrjen aktive të secilit individ.

Veprimtaria shëndetësore-parandaluese dhe sociale-humanitare

Përmes veprimtarisë shëndetësore-parandaluese dhe sociale-humanitare kujdesemi për përmirësimin e shëndetit dhe mirëqenies së popullsisë. Si organizatë komunale, do të vazhdojmë të zbatojmë aktivisht aktivitetet e lidhura me veprimtarinë sociale-humanitare përmes mbështetjes së kategorive të cënueshme të qytetarëve, sigurimit të ndihmës së nevojshme dhe forcimit të humanizmit në komunitetin lokal. Përmes kësaj veprimtarie do të përpiqemi të sigurojmë ndihmë humanitare për të paktën 700 familje. Në kuadër të veprimtarisë shëndetësore-parandaluese, do të punojmë për rritjen e vetëdijes për zakonet e shëndetshme të jetesës, parandalimin e sëmundjeve të ndryshme dhe informimin e duhur dhe në kohë të popullsisë. Investimi në parandalim ka një ndikim të drejtpërdrejtë pozitiv në gjendjen shëndetësore të komunitetit. Me këto aktivitete do të edukojmë të paktën 3,000 individë për mënyrat e mbrojtjes së shëndetit të tyre nga lloje të ndryshme sëmundjesh. Do të punojmë me përkushtim për të krijuar një shoqëri me më shumë mbështetje, solidaritet dhe siguri shëndetësore.

Dhurimi i gjakut

Dhurimi vullnetar i gjakut është një nga prioritetet më të rëndësishme të Kryqit të Kuq. Me dhënien e gjakut shpëtohen jetë njerëzore dhe nxiset humanizmi dhe solidariteti midis njerëzve. KKR – OK Çair organizon aksione për dhurimin e gjakut, promovon vetëdijen për rëndësinë e dhurimit vullnetar dhe bashkëpunon me Institutin e Transfuzionit për për-

punimin e mëtejshëm të gjakut. Në vitin e ardhshëm, sipas Planit Vjetor Integral për aksionet e dhurimit të gjakut, KKR – OK Çair do të organizojë 28 aksione të rregullta për dhurimin e gjakut, ndërsa gjithashtu do të organizohen edhe 10 aksione shtesë, të cilat do të përqipemi t'i bëjmë pjesë të aksioneve të rregullta vitin tjetër. KKR – OK Çair gjithashtu punon për promovimin dhe motivimin e dhuruesve të gjakut. Edukimet motivuese zhvillohen në shkolla, fakultete, organizata punësimi dhe komunat lokale. Gjatë vitit 2026 do të mbahen 12 edukime motivuese në shkollat e mesme dhe fakultete, ndërsa në organizatat e punësimit dhe komunat lokale do të zhvillohen 10 edukime shtesë.

Ndihma e parë

Kjo veprimtari është një nga segmentet më të rëndësishme të punës së KKR – OK Çair dhe për këtë arsye ne vazhdimisht investojmë në rritjen e njohurive dhe përgatitjes së popullatës. Në kuadër të organizatës komunale organizojmë gara komunale nga ndihma e parë, ku marrin pjesë 21 shkolla fillore dhe 4 shkolla të mesme. Këto gara përfaqësojnë një hapësirë të rëndësishme për të rinjtë për të fituar aftësi praktike, ndjenjë përgjegjësie dhe humaniteti. Të paktën 250 nxënës gjatë vitit 2026 do të përfshihen aktivisht në aktivitete të lidhura me garat komunale. KKR – OK Çair gjithashtu punon me përkushtim për trajnimin e popullatës së rritur. Ne realizojmë edukime për ndihmën e parë në kompani, organizata partnere, institucione lokale, institucione publike dhe kopshte, pra në të gjitha vendet ku ka interes për zhvillimin e tyre. Në vitin 2026 planifikojmë që të paktën 600 persona të trajnohen përmes gjithsej 30 seancave edukative.

Diseminimi dhe KKA-PVH

Diseminimi përfaqëson përhapjen e njohurive mbi parimet themelore, misionin dhe vlerat e Kryqit të Kuq, si dhe mbi

Ligjin Humanitar Ndërkombëtar. Gjatë vitit 2026 do të përfshijmë të paktën 800 qytetarë përmes seancave informuese, ligjëratave dhe aktiviteteve në shkolla, institucione dhe në komunitet, ndërsa numri i seancave të realizuara të diseminimit do të rritet sipas interesit të komunitetit. Ky segment krijon qytetarë të përgatitur dhe të informuar që kuptojnë dhe mbështesin misionin humanitar. Përmes programit KKA-PVH gjatë vitit 2026 do të trajnojmë 60 të rinj të cilët me aktivitetet e tyre do të ofrojnë ndihmë dhe mbështetje për popullatën dhe komunitetin. Ata përmes projekteve të tyre të vogla do të arrijnë tek një numër i madh individësh dhe familjesh në territorin e organizatës komunale.

Të rinjtë

Të rinjtë përfaqësojnë fuqinë lëvizëse të humanizmit dhe një shtyllë themelore të zhvillimit të organizatës. CKKR – OK Çair vazhdimisht investon në zhvillimin e tyre personal dhe vullnetar përmes Klubeve të Edukimit dhe Parandalimit në shkollat e mesme dhe seksioneve shkollore në shkollat fillore, me trajnime, iniciativa kreative dhe përgjegjësi shoqërore. Gjatë vitit 2026 pritet që të përfshihen në aktivitete të paktën 150 vullnetarë të rinj, të cilët do të realizojnë më shumë se 30 aksione rinore të drejtuara drejt ndihmës së grupeve vulnerabël, përmirësimit të komunitetit dhe promovimit të vlerave humane. Qëllimi ynë është të krijojmë një gjeneratë që do të përgjigjet ndaj nevojave të komunitetit dhe do të kontribuojë aktivisht në përparimin e tij përmes solidaritetit, inkluzivitetit dhe përgjegjësisë.

Përgatitja dhe veprimi në raste fatkeqësish

Në kohë kur ndryshimet klimatike rrisin rrezikun e shfaqjes së fatkeqësive natyrore dhe teknologjike, përgatitja e drejtë në kohë e vullnetarëve dhe popullsisë ka rëndësi thelbësore. Gjatë vitit 2026 fokusi do të vendoset në fuqizimin e kapacite-





teve përmes trajnimeve për reagim gjatë krizave, ushtrimeve të evakuimit dhe përforsimit të koordinimit me institucionet lokale. Përmes ushtrimeve simuluese të evakuimit në rast zjarri/përmytje/ tërmet do të përfshijmë të paktën 1200 individë, të cilët do të fitojnë njohuri bazë. Prioriteti ynë është krijimi i një komuniteti të përgatitur që di si të mbrojë veten dhe të tjerët në momentet e rrezikut.

Bashkëpunimi me partnerë dhe informimi

Bashkëpunimi me partnerët mundëson zbatimin më të suksesshëm të programeve humanitare dhe ofrimin më të shpejtë të ndihmës për ata që kanë më shumë nevojë. Përmes aksioneve dhe bashkëpunimit sigurohen burime, ekspertizë dhe mbështetje për aktivitetet nga të gjitha fushat e KKRМ – OK Çair. Një falënderim i veçantë i shprehim bashkëpunëtorëve tanë, si: Poliklinika Bit Pazar, PZU VIS Medika, PZU Visar, Poliklinika Çair, Poliklinika Shuto Orizarë, NP "Ujësjellësi dhe Kanalizimi", Bashkitë lokale Çair, Butel, Çuçer Sandevë dhe Shuto Orizarë, universitetet "– Nëna Tereza" dhe Universiteti Ndërkombëtar Ballkanik, shkollat fillore dhe të mesme, çerdhet, Shtëpia e të Moshuarve VITA VE, Olimpia Motors, Klubi i pensionistëve Butel, AD Butel, Esnaf i Çarshisë së Vjetër të Shkupit, JU për rehabilitimin e fëmijëve dhe të rinjve, ZRURZ Romano Çachipe, OURC Idrina, DPD Bajram Miftari, Ansambli "Vanja Lazarova", Gjysëm HënaTurke, OHK Merhamet, Kazerma Ilinden, Oksa Solushën, City Taxi, Furra "Dime", Teteks, ndërsa gjithashtu do të përpiqemi të rrisim numrin e bashkëpunëtorëve dhe partnerëve për të zgjeruar kapacitetet e disponueshme.

Informimi

KKRM – OK Çair informon publikun e gjerë për aktivitetet e tij përmes disa platformave të rrjeteve sociale, përfshirë faqen e

internetit [www.crvenkrst-cair.org.mk](<http://www.crvenkrst-cair.org.mk>), profilin në Facebook – Crven krst Çair, faqen në Facebook – Crven krst Çair / Kruqi i Kuq Çair, profilin në Instagram – redcrosscair, profilin në TikTok – redcrosscair, ku gjithsej ka 7,415 ndjekës. Përmes informimit të duhur në kohë, arrijmë të forcojmë transparencën dhe të zgjerojmë rrjetin tonë të mbështetësve, të cilët janë të motivuar për të marrë pjesë aktivisht në aktivitetet dhe projektet tona të ardhshme.



BUXHETI

TË KRYQIT TË KUQ ÇAIR PËR VITIN 2026

	Të ardhura nga Lighi për KKRM	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
HARXHIME	4,000,000.00	3,000,000.00	7,000,000.00	7,200,000.00	0.00
HARXHIME PËR RROGA DHE KOMPENSIME	1,500,000.00	1,720,000.00	3,220,000.00	2,250,000.00	46.00
HARXHIME MATERIALE	0.00	400,000.00	400,000.00	500,000.00	5.71
HARXHIME FUNKSIONALE	2,500,000.00	760,000.00	3,260,000.00	4,200,000.00	46.57
HARXHIME KAPITALE	120,000.00	120,000.00	250,000.00	1.71	
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	3,000,000.00	7,000,000.00	7,200,000.00	0.00
DALLIMI					00.00

TË ARDHURA	Të ardhura nga Lighi për KKRM	Të ardhura të tjera	Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
Mjete të përcjellura nga të ardhurat shtesë nga viti I kaluar		900,000.00	900,000.00	1,300,000.00	
Të ardhura nga qiratë			0.00	0.00	
Të ardhura nga buxheti lokal		200,000.00	200,000.00	0.00	
Të ardhura nga ndihma e parë		300,000.00	300,000.00	400,000.00	
Donacione dhe sponsorizime		600,000.00	600,000.00	600,000.00	
Të ardhura nga KKRMV	4,000,000.00		4,400,000.00	4,200,000.00	
Nga regjistrimi i veturave			4,000,000.00	4,000,000.00	
Nga projekte		280,000.00	280,000.00	280,000.00	
Dhurimi i gjakut		400,000.00	400,000.00	200,000.00	
Fond për zhvillim dhe projekte të KKRMV			0.00	0.00	
Të ardhura nga kamata			0.00	0.00	
Të ardhura nga anëtarësia		150,000.00	150,000.00	150,000.00	
Të ardhura tjera		450,000.00	450,000.00	550,000.00	
Të ardhura nga shërbime tjera			0,00	0,00	
GJITHSEJ TË ARDHURA	4,000,000.00	3,000,000.00	7,000,000.00	7,200,000.00	

HARXHIME			Buxhet 2026	Buxhet 2025	%
RROGA DHE KOMPENSIME	1,500,000.00	1,720,000.00	3,220,000.00	2,250,000.00	
Rroga bruto	1,500,000.00	1,620,000.00	3,120,000.00	2,150,000.00	
Kompensim për pushim vjetor		100,000.00	100,000.00	100,000.00	
Çmime jubilarë			0.00	50,000.00	
Kompensime për pension			0.00	0.00	
Pagesa tjera			0.00	0.00	
HARXHIME MATERIALE	0.00	400,000.00	400,000.00	500,000.00	
HARXHIME DITORE PËR UDHËTIM					
Mëditje në vend			0.00	0.00	
Mëditje për udhëtime jashtë vendit		20,000.00	20,000.00	20,000.00	
RRYMË E HARXHUAR					
Energji elektrike		50,000.00	50,000.00	100,000.00	
Harxhime për ujë		8,000.00	8,000.00	15,000.00	
Mbeturina		15,000.00	15,000.00	15,000.00	
Ngrohje		50,000.00	50,000.00	0.00	
KOMUNIKIM DHE TRANSPORT					
Posta			0.00	0.00	
Telefon		32,000.00	32,000.00	32,000.00	
Internet			0.00	0.00	
Karburant		30,000.00	30,000.00	60,000.00	
Harxhime për regjistrim të veturave		30,000.00	30,000.00	20,000.00	
Harxhime tjera për transport (pagesa rrugore, larja e veturave, ngjitja e gomave)		5,000.00	5,000.00	10,000.00	

	Buxhet 2026		Buxhet 2025	%	
MATERIALE					
Material zyreje	20,000.00	20,000.00	30,000.00		
Abonim për revista		0.00	0.00		
Pije dhe artikuj ushqimor	15,000.00	15,000.00	15,000.00		
Pajisje për higjienë	10,000.00	10,000.00	15,000.00		
Pagesa për reprezentacion		0.00	0.00		
Materiale tjera		0.00	0.00		
MIRËMBAJTJE RJEDHËSE					
Riparim dhe mirëmbajtje të veturave	25,000.00	25,000.00	20,000.00		
Harxhime për mirëmbajtje të pajisjeve	0.00	0.00	15,000.00		
Harxhime për mirëmbajtje të ndërtesës	30,000.00	30,000.00	36,000.00		
Mirëmbajtje të softuerit dhe harduerit		0.00	0.00		
SHËRBIME TJERA TË KONTRAKTUARA					
Shërbime avokati		0.00	0.00		
Shërbime intelektuale shërbime konsultuese etj)		0.00	0.00		
Shërbime financiare (marrëveshje në vepër, shërbime konsultuese etj)	0.00	0.00	52,000.00		
Provizion bankar	30,000.00	30,000.00	15,000.00		
Sigurim i pronës dhe të të punësuarve	30,000.00	30,000.00	30,000.00		
Shërbime tjera		0.00	0.00		
HARXHIME FUNKCIONALE	2,500,000.00	760,000.00	3,260,000.00	4,200,000.00	
VEPRIMTARI					
Organizim dhe zhvillim	80,000.00	70,000.00	150,000.00	200,000.00	
Seanca e Bordit drejtues	25,000.00		25,000.00	30,000.00	
Kuvendi I OKK//KKQSH	25,000.00		25,000.00	30,000.00	
Informim dhe komunikim	50,000.00	50,000.00	100,000.00	150,000.00	
Diseminim	150,000.00		150,000.00	200,000.00	
Veprimtaria shëndetësore edukative	300,000.00		300,000.00	500,000.00	
Ndihma e parë		300,000.00	300,000.00	400,000.00	
Dhurimi i gjakut		200,000.00	200,000.00	400,000.00	
Veprimtaria Sociale-humanitare	500,000.00		500,000.00	650,000.00	
Shërbimi kërkesë			0,00	0,00	
Marketing	50,000.00	0.00	50,000.00	100,000.00	
Financa	72,000.00		72,000.00	0.00	
Fatkeqësi (minimum 5% nga të ardhurat në baza të regjistrimit të veturave)	700,000.00		700,000.00	750,000.00	
Bashkëpunim ndërkombëtar	100,000.00		100,000.00	200,000.00	
Të rinjtë	400,000.00		400,000.00	400,000.00	
MJETE TË PËRCJELLURA					
Transfere deri te organizatat bazë të KK	48,000.00	20,000.00	68,000.00	70,000.00	
Kotizim për KKR MV		120,000.00	120,000.00	120,000.00	
HARXHIME KAPITALE	0.00	120,000.00	120,000.00	250,000.00	
BLERJE E MOBILJEVE DHE PAJISJEVE PËR ZYRË					
Blerje të mobiljeve për zyrë		20,000.00	20,000.00	50,000.00	
Blerje të pajisjeve për IT dhe të tjera		50,000.00	50,000.00	150,000.00	
BLERJE TË AUTOMJETEVE					
Blerje të veturave			0.00	0.00	
MIRËMBAJTJE THEMELORE DHE SPECIALE					
Rekonstruim dhe renovim të objekteve ndërtimore		50,000.00	50,000.00	50,000.00	
GJITHSEJ HARXHIME	4,000,000.00	3,000,000.00	7,000,000.00	7,200,000.00	100.00





INTRODUCTION

The Work Program of the Red Cross of the City of Skopje for 2026 represents a strategic direction and operational framework for the implementation of the organization's activities in the upcoming period. Next year is of particular importance, as elections will be held within the organization, which represents an opportunity for renewal, strengthening and further development of the volunteer structure and organizational capacities.

